

MEDIA MATRIX
NDËRTHURJA E INTERESAVE

EKSPOZIMI EKONOMIK I MEDIAS & RREZIQET PËR PAVARËSINË EDITORIALE NË SHQIPËRI

Indikatorë, tipologji rastesh dhe rekomandime për transparencë



Ky publikim është përgatitur me mbështetjen e National Endowment for Democracy.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Qendrës Res Publica dhe në asnjë mënyrë nuk mund të interpretohet se reflekton opinionin e National Endowment for Democracy.

Autorë:

Dr. Irena Dule
Av. Dorian Matlija

Botues: Qendra “Res Publica”
Tirazhi: 100 kopje
Kopertina: Dorian Matlija
Print: Expo Vision Albania

© Res Publica 2026

**EKSPozIMI
EKONOMIK I MEDIAS
DHE REZIQET
PËR PAVARËSINË
EDITORIALE
NË SHQIPËRI**

Indikatorë, tipologji rastesh dhe rekomandime për transparencë

PËRMBAJTJA

7 Hyrje

9 Metodologjia

11 Konteksti legjislativ dhe politiko-shoqëror

11 Kuadri ligjor dhe logjika e transparencës së pronësisë në median audiovizive

12 Kuadri politiko-shoqëror

13 Standarde Evropiane dhe detyrime integrimi

15 Kampioni dhe profilet e mediave

15 Mediat kombëtare të licencuara dhe "pasaportat" përkatëse

18 Mediat lokale të licencuara dhe "pasaportat" e tyre

20 Ekspozimi i interesave

20 Ekspozimi ekonomik, përmes statusit të posaçëm, lehtësimeve dhe aseteve publike

21 Statusi "Investim/Investitor Strategjik" dhe masat mbështetëse

25 Asimetria e politikave kompensuese të shtetit dhe e trajtimeve preferenciale për disa media

28 Ekspozimi ekonomik përmes interesave tregtare dhe sektorëve të rregulluar

51 Konkluzione & Rekomandime

51 Konkluzione

52 Rekomandime

SHKURTIME

AAPSK – Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara
ADTN – Albanian Digital Television Network
AIDA – Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
AKB – Agjencia Kombëtare e Bregdetit
AMA – Autoriteti i Mediave Audiovizive
AVMSP – Audiovisual Media Service Provider / Ofrues i Shërbimit Mediatik Audioviziv
BE – Bashkimi Evropian
BOT – Build–Operate–Transfer
DD1 – Dividenti Digjital 1
DVB-T2 – Digital Video Broadcasting – Second Generation Terrestrial
EMFA – European Media Freedom Act
EU – European Union
GJEDNJ – Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
HEC – Hidrocentral
IEOM – International Election Observation Mission
IT – Teknologjia e Informacionit
KIS – Komiteti i Investimeve Strategjike
KKT – Këshilli Kombëtar i Territorit
KKTU – Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit
KUZ – Kanalizime të Ujërave të Zeza
MPEG-4 – Moving Picture Experts Group – Standardi MPEG-4
NIPT – Numri i Identifikimit për Personin e Tatueshëm
NUIS – Numri Unik i Identifikimit të Subjektit
ODIHR – Office for Democratic Institutions and Human Rights
OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OSCE – Organization for Security and Co-operation in Europe
OSHMA – Ofrues i Shërbimit Mediatik Audioviziv
PACE – Parliamentary Assembly of the Council of Europe
PPP – Partneritet Publik-Privat
QKB – Qendra Kombëtare e Biznesit
RTSH – Radio Televizioni Shqiptar
RTV – Radio Televizion
SHA / sh.a. – Shoqëri Aksionare
SHPK / sh.p.k. – Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SPAK – Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
SPV – Special Purpose Vehicle / Shoqëri e Posaçme Projekti
TV – Televizion
UK – Ujësullës-Kanalizime
VKM – Vendim i Këshillit të Ministrave
ZK – Zonë Kadastrale

I. HYRJJE

Ky raport nis nga një pyetje shumë praktike. Kur një media ka përreth një rrjet të gjerë interesash ekonomike dhe një ekspozim të lartë ndaj vendimmarrjes publike, sa e lehtë bëhet ruajtja e pavarësisë editoriale dhe fjala e lirë? Nuk bëhet fjalë për të gjykuar përmbajtjen e një programi apo “linjën editoriale” të një redaksie. Bëhet fjalë për të parë kushtet strukturore që e bëjnë pavarësinë më të vështirë, sidomos në një treg të vogël dhe të përqendruar si i yni.

Raporti është një ushtrim monitorimi të dukurisë së ekspozimit ekonomik të medias. Res Publica mblodhi dhe sistemoi të dhëna të verifikueshme për të kuptuar se si krijohet ky ekspozim. Përmes pronësisë dhe kontrollit të deklaruar, përmes rrjeteve të bizneseve të lidhura me pronarët dhe familjarët e tyre, si edhe përmes gjurmëve të marrëdhënies me shtetin, qoftë në formë financimi direkt (pagesa, kontrata, tendera, transfertat), qoftë në formë përfitimesh rregullatore/administrative me peshë ekonomike (status i posaçëm, lehtësime, përdorim/transferim asete publike, etj.). Raste konkrete përmenden vetëm si ilustrime të dokumentuara, për të shpjeguar fenomenin dhe për të mbështetur rekomandimet, pa synuar “profilizim” mediash apo vendosje etiketimesh politike. Për këtë arsye, rastet e trajtuara janë kryesisht ato me ekspozim më të lartë dhe më shqetësues, të përzgjedhura për vlerën e tyre shpjeguese; ato nuk pretendojnë të jenë kampion përfaqësues i gjithë tregut dhe nuk duhet të përdoren për të paragjykuar çdo media. Përkundrazi, qëllimi është të identifikohen mekanizmat që kur shfaqen krijojnë avantazh të padrejtë dhe konkurrencë të pandershme, duke dëmtuar edhe mediat që operojnë me qëllim të çiltër dhe standarde profesionale.

Fokusi kryesor i raportit janë mediat audiovizive, sepse synimi është që gjetjet dhe rekomandimet të jenë të përdorshme në debatin dhe procesin e pritshëm të ndryshimeve në ligjin e mediave audiovizive. Megjithatë, raporti nuk i anashkalon mediat online. Sot ndikimi informativ nuk ndalet te ekrani, dhe pothuajse çdo media kryesore audiovizive operon paralelisht edhe një portal online me audiencë të lartë. Për këtë arsye, pjesa e mediave online trajtohet si shtresë plotësuese për të kuptuar shtrirjen reale të ndikimit të të njëjtëve aktorë, pa e zhvendosur fokusin nga audiovizivi.

Në këtë kuadër, mediat kombëtare audiovizive merren si raste studimi, ndërsa mediat lokale/ rajonale janë përzgjedhur sipas një kombinimi faktorësh mes shtrirjes së ndikimit dhe rëndësisë që ka marrë në diskursin publik.

Për çfarë shërben ky raport? Së pari, për të kuptuar rrezikun, pasi evidenton zona ku mund të shfaqen varësi ekonomike ose konflikt interesi, që edhe pa “urdhra” dhe pa prova ndërhyrjeje, mund të dobësojnë pavarësinë editoriale dhe besimin e publikut te media. Së dyti, për debat dhe rekomandime, pasi ofron një instrument referimi që mund të përdoret për monitorim të mëtejshëm dhe për masa rregullatore që rrisin transparencën dhe llogaridhënien. Së treti, për transparencë, pasi krijon një bazë të dhënash mbi lidhjet kryesore pronësore dhe ekonomike përreth mediave të analizuara.

Ky raport është menduar si kontribut praktik në një moment të rëndësishëm, që përkon me rishikimin e pritshëm të kuadrit ligjor për median audiovizive dhe me përafrimin gradual me standardet europiane në kuadër të procesit të integritimit. Në këtë kontekst, raporti merr në konsideratë edhe kërkesat dhe standardet e vendosura nga European Media Freedom Act (EMFA), veçanërisht në lidhje me transparencën e pronësisë, mbrojtjen e pavarësisë editoriale dhe kufizimin e ndërhyrjeve të padrejta në media.

Për këtë arsye, gjetjet nuk paraqiten si një listë problemesh, por si bazë monitorimi për të identifikuar boshllëqet rregullatore që krijojnë ekspozim ekonomik dhe rreziqe për pavarësinë editoriale. Raporti i lidh këto gjetje me kërkesat e transparencës, pluralizmit dhe mbikëqyrjes së pavarur që burojnë nga kuadri i BE-së, duke përfshirë EMFA, me synim që rekomandimet të jenë të zbatueshme, të matshme dhe të orientuara drejt reformës.

Në vijim paraqitet metodologjia e mbledhjes së të dhënave dhe përzgjedhjes së kampionit, dhe më pas rezultatet: “pasaportat” e mediave, tipologjitë e ekspozimit ekonomik dhe rekomandimet për transparencë.

Përgatitën raportin:

Dr. Irena Dule
Av. Dorian Matlija

Ndihmuan në mbledhjen e të dhënave:
Av. Brunilda Qershori
Esmeralda Hoxha

II. METODOLOGJIA

Analiza është ndërtuar rreth subjekteve që ushtrojnë veprimtari në një sektor të rregulluar posaçërisht me ligj dhe që, për vetë natyrën e tij, ka rëndësi të veçantë publike për pluralizmin, pavarësinë editoriale dhe transparencën e pronësisë.

Mediat online nuk trajtohen si kategori më vete e rasteve studimore. Kjo lidhet, së pari, me faktin se fokusi normativ i raportit është ligji për median audiovizive dhe mekanizmat e rregullimit të këtij sektori, dhe, së dyti, me faktin se një pjesë e mediave online me ndikimin më të madh rezultojnë të jenë në pronësi ose nën kontrollin e të njëjtave familje apo grupime ekonomike që zotërojnë edhe licenca audiovizive. Për rrjedhojë, prania online trajtohet vetëm si një element plotësues i analizës, që ndihmon në vlerësimin më të saktë të ndikimit real informues të të njëjtëve aktorë mediatikë, pa e zhvendosur fokusin kryesor të raportit nga tregu audioviziv.

Përzgjedhja e kampionit bazohet në logjikën e rastit studimor. Qëllimi nuk është të ndërtohet një inventar i përgjithshëm i të gjitha mediave apo i të gjitha marrëdhënieve ekonomike përreth tyre, por të evidentohen modele dhe mekanizma ekspozimi ekonomik që ndihmojnë për të kuptuar më mirë rreziqet ndaj pavarësisë së medias dhe mangësitë e kuadrit ekzistues rregullator.

Sa u takon mediave kombëtare audiovizive, ato janë përfshirë të gjitha në analizë. Kjo zgjedhje lidhet me rëndësinë e tyre në tregun mediatik shqiptar, me shtrirjen kombëtare të transmetimit, me peshën që kanë në formësimin e opinionit publik dhe me faktin që veprojnë nën një regjim licencimi me interes të lartë publik.

Ndërkohë, mediat lokale dhe rajonale nuk janë përfshirë në tërësi, por janë përzgjedhur mbi bazën e dy kritereve të kombinuara. Kriteri i parë është ai i shtrirjes dhe mbulimit relativisht më të gjerë, sipas të dhënave që rezultojnë nga licencat, si tregues i audiencës potenciale dhe i peshës së tyre në zonën përkatëse. Kriteri i dytë është ai cilësor, i lidhur me faktin nëse këto media ose pronarët e tyre kanë qenë objekt diskutimi në hapësirën publike, përmes debateve të dokumentuara, referencave të përsëritura në burime të hapura, apo indicieve të tjera që kanë ngritur pikëpyetje mbi marrëdhëniet e tyre me pushtetin politik, ekonomik ose institucional.

Mbledhja dhe verifikimi i të dhënave është ndërtuar në disa nivele. Si pikënisje janë përdorur të dhënat publike mbi pronësinë formale të mediave, të marra nga Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe nga Regjistri Kombëtar i Bizneseve, për të identifikuar subjektin ligjor dhe strukturën e deklaruar të pronësisë. Më pas, analiza zgjerohet përtej pronësisë në kuptimin e ngushtë, duke verifikuar nëse aksionarët, ortakët ose pronarët përfitues zotërojnë edhe biznese të tjera, si dhe nëse familjarë të afërt të tyre shfaqen të lidhur me subjekte të tjera tregtare. Qëllimi nuk është inventarizimi i pasurive private, por rindërtimi i kontekstit ekonomik në të cilin operon media.

Hipoteza udhëheqëse e këtij monitorimi është se, në një treg të vogël dhe të përqendruar si ai shqiptar, ndikimi ekonomik mbi median nuk shfaqet vetëm përmes pagesave direkte ndaj subjektit mediatik, por edhe përmes ekspozimit ekonomik të pronarëve, familjarëve të tyre ose subjekteve të tjera të lidhura me ta ndaj vendimmarrjeve publike. Për këto arsye, të dhënat janë përdorur për të vlerësuar ekspozimin ekonomik në dy plane kryesore:

- Plani i parë është ekspozimi rregullator ose administrativ me peshë ekonomike, ku përfshihen lehtësitë, statuset e posaçme, përdorimi ose transferimi i aseteve publike, lejet, autorizimet, koncesionet dhe trajtime të tjera preferenciale.
- Plani i dytë është ekspozimi financiar përmes fondeve publike, ku përfshihen transaksionet e thesarit, kontratat publike, prokurimet, projektet e financuara nga shteti dhe forma të tjera përfitimesh monetare nga buxheti i shtetit.

Përveç burimeve të hapura dhe regjistrave publikë, metodologjia mbështetet edhe në verifikim cilësor përmes konsultimeve me gazetarë investigativë dhe njohës të sektorit, me synim testimin e gjetjeve, identifikimin e boshllëqeve në të dhënat publike dhe orientimin drejt dokumenteve primare kur kjo është e nevojshme. Këto konsultime nuk përdoren si zëvendësim i provës dokumentare, por si mjet ndihmës për të ndërtuar më saktë pistat e kërkimit.

E gjithë analiza ndërtohet mbi një zinxhir standardizues verifikimi. Media lidhet me subjektin ligjor përkatës; subjekti ligjor lidhet me pronarët e deklaruar; pronarët lidhen me persona të afërt dhe me subjekte të tjera ekonomike; dhe në fund kërkohen indikatorë të ekspozimit financiar ose rregullator që mund të jenë të rëndësishëm për vlerësimin e rrezikut të ndikimit.

Raporti ruan një standard të kujdesshëm evidencash dhe etikash. Transparenca e pronësisë mund të jetë e pjesshme për shkak të zinxhirëve të ndërlikuar korporativë, ndërsa të dhënat mbi fondet publike dhe përfitimet e tjera ekonomike mund të jenë të shpërndara ose jo plotësisht të aksesueshme. Për këtë arsye, raporti dokumenton faktet, ndërsa interpretimet i mban në nivel indikatorësh monitorimi dhe jo si përfundime automatike mbi ndikimin editorial ose paligjshmërinë.

Së fundi, raporti përdor edhe një kornizë referimi ligjor dhe rregullator për të strukturuar analizën dhe për të orientuar rekomandimet. Kjo kornizë përfshin legjislacionin shqiptar për median audiovizive, rregullat mbi transparencën e pronësisë, standardet që lidhen me pluralizmin dhe pavarësinë e medias, si edhe standardet europiane për transparencën, pavarësinë editoriale dhe mbrojtjen nga ndërhyrjet e padrejta ekonomike ose politike.

III. KONTEKSTI LEGJISLATIV DHE POLITIKO-SHOQËROR

3.1. Kuadri ligjor dhe logjika e transparencës së pronësisë në median audiovizive

Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, e trajton transparencën e pronësisë si parakusht për pluralizmin dhe mbikëqyrjen rregullatore, duke e lidhur licencimin me formën juridike dhe me rregulla të posaçme kundër përqendrimit. Në këtë kuadër, operatorët mediatikë (OSHMA-të) mund të jenë shërbime publike, private, tregtare ose jotregtare, në varësi të formës së pronësisë mbi kapitalin dhe qëllimit të veprimtarisë (neni 31).

Bërthama e kësaj filozofie shprehet në nenin 62 të ligjit, i cili vendos standarde të ndryshme për operatorët kombëtarë dhe operatorët lokalë/rajonalë.

Së pari, për licencat kombëtare kërkohet që ato t’u jepen vetëm shoqërive aksionare (SHA) të regjistruara në Shqipëri, me objekt ekskluziv audioviziv, dhe që aksionet të jenë nominative. Këto dy kërkesa (“SHA” + “aksione nominative”) synojnë të rrisin gjurmueshmërinë e kontrollit, pra, të bëjnë më të identifikueshme se kush e zotëron kapitalin dhe si ndryshon pronësia në kohë, në përputhje edhe me kuadrin e përgjithshëm të shoqërive tregtare, ku ligji nr. 9901/2008 parashikon se shoqëria aksionare mund të jetë me ose pa ofertë publike, por gjithsesi ruan një regjim më të standardizuar të regjistrimit/transferimit të aksioneve.

Së dyti, neni 62 ndërton një bërthamë anti-përqendrimi duke vendosur kufij për pjesëmarrjen e një personi fizik/juridik në më shumë se një subjekt të licencuar, me pragje më të rrepta për kombëtares dhe pragje të tjera për lokalet/rajonalet. Për të mbyllur hapësirat e shmangies formale, ligji parashikon shprehimisht se, për qëllimet e nenit 62, “aksionar” konsiderohet jo vetëm mbajtësi i aksioneve, por edhe personat e lidhur deri në shkallën e dytë, duke e bërë transparencën familjare pjesë të logjikës rregullatore.

Së treti, ligji e lidh transparencën e pronësisë me dimensionin ekonomik të tregut, duke vendosur tavan për dominimin e reklamave nga operatorët kombëtarë dhe duke ngarkuar AMA-n me monitorim dhe publikim periodik të volumit të reklamave. Së katërti, ligji diferencon standardet sipas shkallës së ndikimit: kërkesat formale janë më të larta për operatorët kombëtarë, ndërsa për operatorët lokalë/rajonalë parashikohet një regjim

më fleksibël hyrjeje (praktikisht shpesh SHPK), i shoqëruar me kufizime të posaçme për kryqëzimin e pronësinë (p.sh. tavanet 40% dhe rregullat për licencën e dytë).

Në tërësi, skema ligjore del e qartë. Forma SHA dhe aksionet nominative synojnë ta bëjnë pronësinë më të lexueshme, kufijtë e pjesëmarrjes dhe koncepti i personave të lidhur synojnë të frenojnë përqendrimin (edhe kur maskohet përmes rrethit familjar), ndërsa kufijtë në reklama synojnë të kufizojnë dominimin ekonomik. Kjo është arsyeja pse, edhe kur mediat kombëtare rezultojnë de facto biznese familjare, ligji i vendos ato brenda një kornize që synon ta bëjë kontrollin formal dhe ndryshimet e pronësisë më të gjurmueshme dhe më të verifikueshme për AMA dhe publikun.

Megjithatë, pavarësisht kësaj arkitekture formale, zbatimi praktik i këtyre dispozitave tregon kufij të qartë. Problemi kryesor i kuadrit rregullator nuk qëndron vetëm te mungesa e rregullave, por te kufizimi i tyre në nivel formal. Neni 62 mbetet një pikënisje e rëndësishme, por në formën aktuale ai nuk mjafton për të kapur kontrollin real mbi median. Ai mund të evidentojë aksionerë formalë, por jo domosdoshmërisht marrëdhëniet reale të kontrollit, zinxhirët e pronësisë, personat e lidhur, shpërndarjen faktike të ndikimit apo ndërthurjen me interesa të tjera ekonomike. Për këtë arsye, ekziston rreziku që norma të funksionojë si një kërkesë deklarative, pa arritur të prodhojë transparencën materiale që i nevojitet tregut.

Në thelb, neni 62 i ligjit për mediat audiovizive synon të ndërtojë një kornizë rregullatore që i shërben dy objektivave qendrore: rritjes së gjurmueshmërisë së pronësisë dhe kufizimit të përqendrimit të pronësisë dhe të ndikimit ekonomik në tregun audioviziv. Sidoqoftë, analiza tregon se efektiviteti i kësaj dispozite varet jo vetëm nga formulimi ligjor, por sidomos nga instrumentet nënligjore, nga metodologjitë e zbatimit dhe nga kapaciteti real i AMA-s për të monitoruar tregun. Pikërisht këtu shfaqen boshllëqet kryesore.

3.2 Kuadri politiko-shoqëror

Raportet dhe vlerësimet mbi median në Shqipëri theksojnë se ajo operon në një mjedis të polarizuar politikisht, ku pronësia është e përqendruar dhe ku interesat e biznesit dhe politikës shpesh ndërthuren, duke krijuar presione (të drejtpërdrejta ose të tërthorta) mbi autonominë editoriale. Në “Statement of Preliminary Findings and Conclusions” (Deklarata e Gjetjeve dhe Konkluzioneve Paraprake) për zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025, misioni ndërkombëtar i vëzhgimit (IEOM) i përbërë nga OSBE/ODIHR, OSCE PA, PACE dhe Parlamenti Europian, vëren se përqendrimi i pronësisë, vetëcensura dhe dominimi i mbulimit nga dy partitë kryesore kufizuan mundësinë e votuesve për një zgjedhje të informuar.

Në kontekstin shqiptar, përqendrimi i pronësisë lidhet shpesh me faktin se një pjesë e konsiderueshme e mediave zotërohen nga një pronar i vetëm ose nga një strukturë familjare aksionarësh. Kjo e bën më të prekshëm sistemin ndaj ndikimeve që vijnë nga interesa jashtë medias, p.sh. interesa biznesi, kontrata publike, marrëdhënie me institucionet, si dhe rrit rëndësinë e transparencës së kontrollit real, jo vetëm të pronësisë formale.

Në teori, një shpërndarje më e gjerë e kapitalit (p.sh. modele me ofertë publike) do ta vështirësonte kontrollin e përqendruar nga një grup i vetëm, por një model i tillë kërkon treg kapitalesh funksional, standarde të forta raportimi dhe mbikëqyrje efektive. Në një treg të vogël si Shqipëria, rreziku i ndikimit mbetet i lartë dhe, për këtë arsye, kontrolli rregullator dhe transparenca bëhen edhe më të rëndësishme.

Pikërisht për këtë arsye, ky raport edhe kur pasaportat e mediave evidentojnë pronësi familjare që nuk përbën vetvetiu shkelje ligjore e trajton monitorimin si një ushtrim të dyfishtë: (i) të verifikojë strukturën e pronësisë dhe kontrollit (përfshirë zinxhirët dhe personat e lidhur), dhe (ii) të evidentojë indicie të përfitimeve nga fonde publike ose përfitimeve rregullatore/administrative, për të kuptuar kontekstin ekonomik brenda të cilit operon secila media audiovizive.

Ky kapitull konteksti shërben vetëm si kornizë interpretimi për “pasaportat” dhe analizën e mëvonshme. Vlerësimi kritik i nenit 62 dhe rekomandimet rregullatore do të trajtohen pasi të paraqiten gjetjet dhe tipologjitë e rasteve.

3.3. Standarde Evropiane dhe detyrime integrimi

Procesi i anëtarësimit e vendos Shqipërinë përballë një pritshmërie të qartë që është transparenca e pronësisë dhe e financimit të medias duhet të forcohet si pjesë e standardeve të demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Në Raportin e Komisionit European për Shqipërinë (2025)¹ rekomandohet shprehimisht një reformë madhore e kuadrit ligjor dhe rregullator për median, me objektiva të qarta: (i) forcimin e transparencës së pronësisë, pluralizmit dhe pavarësisë editoriale; dhe (ii) forcimin e transparencës së financimit të medias, si nga burime private ashtu edhe nga burime shtetërore.

Po në të njëjtën linjë, kapitulli për Shqipërinë në Raportin e BE për Shtetin e së Drejtës (2025) thekson se përqendrimi i lartë i tregut mediatic dhe mungesa e garancive të mjaftueshme ligjore kundër përqendrimit të pronësisë vazhdojnë të jenë shqetësim për pavarësinë e medias.

Edhe pse jo anëtare, Shqipëria pritet të konvergojë gradualisht me instrumentet më të fundit europiane që po vendosin “minimumin” e transparencës dhe të anti-kapjes në media.

European Media Freedom Act po e kthen transparencën e pronësisë dhe transparencën e “reklamës shtetërore” në standard të unifikuar european. Ai synon, ndër të tjera, transparencë në reklamimin shtetëror, vlerësim të përqendrimeve të rëndësishme të tregut mediatic për efekt pluralizmi/pavarësie editoriale, dhe standarde mbi transparencën e matjes së audiencës. Në literaturën europiane, EMFA shihet si përgjigje ndaj boshllëkut të gjatë rregullator për “beneficial ownership” (pronarët përfitues) dhe për reklamat shtetërore, duke e lidhur transparencën me shmangien e ndikimit politik dhe konfliktit të interesit.

Regullorja (EU) 2024/900 për transparencën dhe targetimin e reklamës politike² është model i ri i BE për “gjurmueshmërinë” e reklamës politike, me detyrime transparence dhe një arkiv publik për reklamat online.

Për Shqipërinë, këto standarde janë të rëndësishme sepse prekin dy hallka që raporti i këtij studimi i identifikon si të ndjeshme: (i) transparencën e kontrollit real (jo vetëm formal) mbi mediat; dhe (ii) transparencën e kanaleve financiare publike që mund të krijojnë ekspozim ekonomik.

1 Raporti i Komisionit European për Shqipërinë (2025), Fq. 7, https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/fe9138b7-90fe-4277-a12c-3a03f6d1957f_en?filename=albania-report-2025.pdf

2 Transparency and targeting of political advertising | EUR-Lex, <https://eur-lex.europa.eu/EN/legal-content/summary/transparency-and-targeting-of-political-advertising.html>

Shtrirja e licencave televizive në Shqipëri (2025)

Popullsia e arritshme dhe mënyra e mbulimit



KOMBËTARE

Licenca me mbulim në të gjithë territorin e Shqipërisë.




MIKSE

Licenca me mbulim thuajse kombëtar



QARQE

Licenca me mbulim në disa qarqe.



QARK I VETËM

Licenca me mbulim në një qark të vetëm.



Kombëtare Mikse Qarqe Qark i vetëm Pezulluar

IV. KAMPIONI DHE PROFILET E MEDIAVE

4.1. Mediat kombëtare të licencuara dhe “pasaportat” përkatëse

Sipas të dhënave të publikuara nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, duke lënë mënjanë median publike, në këtë raport përfshihen pesë operatorë audiovizivë me licencë/shtrirje kombëtare: DigitAlb, Top Channel, ADTN, Vizion Plus (Media Vizion) dhe TV Klan.

Pavarësisht ekzistencës së pesë licencave kombëtare, materialet e këtij raporti tregojnë se pronësia/kontrolli mbi to përqendrohet kryesisht te tre bërthama familjare, të cilat shfaqin edhe lidhje të ndërsjella brenda tregut audioviziv. Kështu, në kampionin e analizës janë:

- (i) familja Hoxha kontrollon Top Channel dhe shfaqet në mënyrë dominuese në DigitAlb, si dhe përmes DigitAlb lidhet me ADTN;
- (ii) familja Frangaj–Gina kontrollon TV Klan, ndërsa Alba Gina evidentohet si aksionere edhe në DigitAlb; dhe
- (iii) familja Dulaku lidhet me Median Vizion Plus (dhe deri në Dhjetor 2025 lidhej edhe me rrjetin Tring).

Në një vështrim monitorues, ky përqendrim ka rëndësi sepse licencimi kombëtar lidhet me përdorimin e frekuencave si pasuri publike me vlerë ekonomike dhe rëndësi sociale/kulturore. Për rrjedhojë, sa më i lartë të jetë përqendrimi i licencave te një numër i kufizuar pronarësh dhe sa më shumë të shfaqen përfitime rregullatore apo financiare nga sektori publik në rrethin e subjekteve të lidhura, aq më e lartë bëhet nevoja për transparencë, arsyetim publik dhe standard të qartë verifikimi.

Për t'i dhënë kuptim strukturës së tregut, pasaportat e mëposhtme organizohen sipas përqëndrimit të kontrollit.

A) Grupi / Familja Hoxha (Top Channel – DigitAlb – ADTN)

Familja Hoxha është zotëruese në tre licenca kombëtare, me 100 % të aksioneve ose shumicën e tyre, të cilat listohen më poshtë

1) *Top Channel sh.a.*

Top Channel operon përmes shoqërisë aksionare Top Channel sh.a. Struktura e pronësisë rezulton e përqendruar te familja Hoxha, e cila zotëron 100% të aksioneve: Vjollca Hoxha (20%) dhe katër fëmijët e saj Lorela Hoxha (20%), Sara Hoxha (20%), Redia Hoxha (20%) dhe Itan Hoxha (20%). Kanali nisi transmetimet në dhjetor 2001 dhe gjatë viteve ka konsoliduar mbulimin kombëtar dhe shtrirjen e transmetimit për audiencën jashtë vendit përmes platformave të shpërndarjes.

Top Channel ka zhvilluar një profil programor të kombinuar (informatik dhe argëtues) dhe ka sjellë si formate të licencuara ndërkombëtare, ashtu edhe programe origjinale vendase. Në historikun e tij raportohen faza rikonfigurimi të pronësisë; më pas, pas një procesi të zgjatur ligjor, çështja e pronësisë u konsolidua sërish brenda familjes Hoxha.

2) *DigitAlb sh.a.*

“Digit-alb” sh.a. është një operator audioviziv i licencuar, i njohur kryesisht si platformë pay-TV (tokësore dhe satelitore), që shpërndan paketa kanalesh për abonentët dhe ofron shërbime transmetimi përmes rrjeteve të veta. Në burime publike rezulton se platforma është themeluar në vitin 2004 dhe ka nisur transmetimet tokësore në korrik 2004, ndërsa shtrirja satelitore është konsoliduar brenda të njëjtit vit.

Sipas strukturës pronësore të publikuar nga AMA, aksionerët e DigitAlb sh.a. përfshijnë: Itan Hoxha (8.56%), Alba Gina (8%), Alban Jaho (2.52%), Enkelejdi Joti (2.52%), Eduard Poda (1.52%), Redia Hoxha (4.19%), si dhe shoqëri juridike si Albsea Transport sh.p.k. (8%), DEM Capital sh.p.k. (8.90%), Arch Investor sh.p.k. (3.20%), E&E Investment sh.p.k. (8.90%), Union Grup sh.p.k. (13.60%) dhe Loresa sh.p.k. (30.07%). Në të njëjtat burime, si pronarë përfitues pasqyrohen Sara Hoxha (30.07%) dhe Lorela Hoxha (30.07%).

3) *ADTN sh.a.*

ADTN sh.a. u pajis me licencë kombëtare në 27.01.2017. ADTN sh.a. figuron në listimet e AMA-s si operator/ofruer shërbimi audioviziv me shtrirje kombëtare (AVMSP). Në regjistrimet publike, objekti i veprimtarisë lidhet me sisteme/rrjete telekomunikacionesh dhe transmetimesh, pajisje të transmetimit/marrjes së sinjaleve dhe shërbime audio-video me komponent digjital. Sipas të dhënave të publikuara nga AMA (bazuar në informacionin e QKB-së), ADTN sh.a. zotërohet 100% nga DigitAlb sh.a.

Në të njëjtat burime, për ADTN sh.a. pasqyrohen si pronarë përfitues (me pjesëmarrje të shënuar si “indirekte”) Lorela Hoxha (30.07%) dhe Sara Hoxha (30.07%). Kjo lidhje shpjegohet me faktin se te DigitAlb sh.a. shoqëria “Loresa” sh.p.k. rezulton aksionere me 30.07% dhe këto dy persona shfaqen si pronarë përfitues “indirekt” në raportimet e AMA-s.

4) *Top-channel.tv*

E njëjta strukturë pronësore shtrihet edhe mbi median online Top-channel.tv, e cila operon si portali zyrtar informativ i televizionit. Kjo platformë shërben si një zgjatim digjital i aktivitetit audioviziv, duke publikuar në kohë reale lajme, përmbajtje video nga programet televizive, si dhe materiale origjinale të përshtatura për audiencën online.

Top-channel.tv renditet ndër portalet më të ndjekura në Shqipëri, me një profil të kombinuar informativ dhe argëtues, duke reflektuar linjën editoriale dhe përmbajtjen e kanalit televiziv. Në këtë kuptim, ai funksionon si pjesë integrale e ekosistemit mediatik të grupit, duke zgjeruar shtrirjen e ndikimit të tij përtej transmetimit tradicional.

B) Grupi / familja Frangaj - Gina (TV Klan dhe lidhjet korporative)

1) TV Klan sh.a.

TV Klan është një kanal televiziv kombëtar me qendër në Tiranë. Transmetimet e para i ka nisur në tetor 1997 dhe në 2001 ka përfituar një nga dy licencat kombëtare të asaj periudhe. Operatori funksionon përmes shoqërisë TV Klan sh.a. (NIPT: J71413001L). Sipas të dhënave të publikuara nga AMA (bazuar në QKB), pronësia është: Aleksandër Frangaj 60% (direkte) dhe Alba Gina 40% (direkte), ndërsa emërtimi tregtar i shoqërisë rezulton i ndryshuar në 2013 nga “Media 6” në “TV Klan”.

TV Klan përmendet si pjesë e një grupi më të gjerë mediash (p.sh. Klan News, Klan Plus dhe Radio Klan). Në burime publike të AMA rezulton gjithashtu se Alba Gina zotëron 8% të aksioneve në platformën me pagesë DigitAlb sh.a., element që ndihmon në kuptimin e lidhjeve korporative brenda tregut audioviziv.

C) Grupi / Familja Dulaku (Vizion Plus – Media Vizion dhe ekosistemi i lidhur)

1) Vizion Plus (Media Vizion)

Vizion Plus operon përmes shoqërisë Media Vizion, e cila administron aktivitetin televiziv të kanalit. Sipas të dhënave të përgjithshme mbi historikun e tij, Vizion Plus nisi transmetimet rreth vitit 2000, u pajis me licencë kombëtare në 2008 dhe në 2016 ka përfituar nga AMA një nga licencat kombëtare për transmetimet numerike.

Media Vizion lidhet me një grup kompanish ku aksionarët kryesorë janë të lidhur me familjen Dulaku (Artan, Adrian dhe Genci Dulaku, si dhe bashkëshortet e tyre). Në komunikime publike të grupit, “Concord Investment” përmendet si një nga shoqëritë qendrore të organizimit të aktivitetit, ndërsa brenda ekosistemit rezultojnë edhe shoqëri të tjera (p.sh. INER, Edil Al IT, Media Vizion) dhe pjesëmarrje në aktivitete të lidhura me platforma transmetimi/shërbime satelitore.

Në këtë kontekst, pjesë e këtij ekosistemi ka qenë edhe platforma Tring TV, një nga operatorët kryesorë të televizionit me pagesë në Shqipëri. Megjithatë, në fund të vitit 2025, kjo platformë ka kaluar në pronësi të re. Konkretisht, përmes një marrëveshjeje shitblerjeje aksionesh të datës 2 tetor 2025, shoqëria “Concord Investment” ka transferuar 100% të aksioneve të Tring TV SHA te shoqëria Vertex Holding sh.p.k., transaksion i cili është autorizuar më pas nga Autoriteti i Konkurrencës në janar 2026.

Shoqëria Vertex Holding është në pronësi të plotë të shtetasit nga Kosova, Valon Shala, i cili rezulton gjithashtu i lidhur me sektorin e telekomunikacionit në rajon, si drejtues dhe përfitues fundor i operatorit Artmotion në Kosovë.

4.2. Mediat lokale të licencuara dhe “pasaportat” e tyre

A. Report TV. Grupi Carlo Bolino

1) Report TV

Report TV operon përmes shoqërisë “MTSC” sh.p.k. (enjo hurmë herësi “MULTISCREEN”), e cila mban licencën për kanalin. Sipas të dhënave të publikuara në burime monitorimi të pronësisë dhe në publikimet periodike të AMA-s, “MTSC” sh.p.k. zotërohet 100% nga Carlo Bollino (pronësi direkte).

2) Shqiptarja.com (media online)

Carlo Bollino është themelues dhe administron edhe median online “shqiptarja.com”

B. News 24; Balkanweb; Fax News; Panorama TV. Grupi Familja/Hysenbelliu

Familja Hysenbelliu përfaqëson një nga bërthamat më të njohura të pronësisë në tregun mediatik shqiptar, me prani të konsoliduar në median audiovizive dhe në platformat online. Më poshtë listohen mediat elektronike (TV/radio/online) të lidhura me familjen Hysenbelliu, sipas të dhënave të aksesueshme publikisht për entitetet përkatëse dhe strukturat e pronësisë.

1) News 24 (TV)

News 24 operon përmes shoqërisë “Focus Media News” sh.p.k. (NIPT: K21909002K). Sipas të dhënave të publikuara nga AMA (bazuar në QKB), aksioneri i vetëm i “Focus Media News” është “Focus Group” sh.p.k. (100%), ndërsa si pronar përfitues (indirekt) rezulton Irfan Hysenbelliu (100%).

2) BalkanWeb.com (portal online)

BalkanWeb.com lidhet me të njëjtin entitet ligjor “Focus Media News” sh.p.k. (NIPT: K21909002K), me aksionar të vetëm “Focus Group” sh.p.k. (100%) dhe pronar përfitues (indirekt) Irfan Hysenbelliu (100%).

3) Radio RASH (radio)

Radio RASH përfshihet në të njëjtën orbitë pronësie të grupit “Focus”, e lidhur me shoqërinë “Focus Media News” sh.p.k., ku aksioneri i vetëm është “Focus Group” sh.p.k. (100%) dhe pronar përfitues (indirekt) rezulton Irfan Hysenbelliu (100%).

4) Fax News TV

Fax News figuron si shërbim audioviziv rajonal me shtrirje në qarqet Tiranë dhe Durrës, dhe lidhet me shoqërinë “Fax Media News” sh.a. Sipas të dhënave të publikuara nga AMA, struktura e aksionerëve është: “Kedo Group” sh.p.k. me 90% dhe Ardian Dushaj me 10% të kuotave. Si pronarë përfitues (indirekt, përmes “Kedo Group”) pasqyrohen, Donika Hysenbelli me 33.33%, Enkeleda Hysenbelli me 33.33% dhe Kevin Hysenbelli me 33.33% të kuotave.

5) *Panorama TV*

Panorama TV operon përmes shoqërisë “Panorama TV” sh.p.k.. Ortakët e shoqërisë janë “Panda Group” sh.p.k. me 60% të kuotave dhe “Panorama Group” sh.a. me 40% të kuotave. Pronarët përfitues janë Fatmir Hysenbelliu me 20% të kuotave dhe Fabiola Hysenbelliu me 20% të kuotave dhe Andrea Nako me 60% të kuotave.

6) *Panorama.com.al (portal online)*

Portali Panorama.com.al është i lidhur me “Panorama Group” sh.a., ku pasqyrohen si pronarë përfitues Fatmir Hysenbelliu (50%) dhe Fabiola Hysenbelliu (50%), duke qenë një tjetër komponent i ekosistemit mediatik të kësaj pjese të grupit.

7) *Gazetashqiptare.al (portal online)*

Gazetashqiptare.al është një tjetër media online në orbitën e grupit Hysenbelliu, e cila operohet përmes shoqërisë “Focus Press” sh.p.k. Kjo shoqëri zotërohet 100% nga “Focus Group” sh.p.k., ndërsa kjo e fundit rezulton në pronësi të plotë të Irfan Hysenbelliu (100%). Për rrjedhojë, Gazetashqiptare.al lidhet drejtpërdrejt me të njëjtën bërthamë pronësore që kontrollon edhe Neës 24 dhe BalkanEeb, duke përforcuar integrimin vertikal të mediave audiovizive dhe online brenda grupit.

C. A2 / G2 Media sh.p.k Grupi/familja Ulaj

1) *Media A2*

Operon përmes shoqërisë “G2 Media” sh.p.k., e cila rezulton me pronësi tërësisht të përqendruar te një subjekt i vetëm. Ortak i vetëm i “G2 Media” sh.p.k. është “ABA MEDIA” sh.p.k. (100%).

Në nivelin pasues të zinxhirit të pronësisë, “ABA MEDIA” sh.p.k. zotërohet 100% nga “ABA HOLDING” sh.p.k. Më tej, “ABA HOLDING” sh.p.k. ka strukturë pronësie të ndarë kryesisht mes tre individëve: Ahmet Ulaj (33%), Bashkim Ulaj (33%) dhe Astrit Ulaj (33%), si edhe një pjesëmarrje në shoqërinë NDD (1%) ku ajo rezulton në pronësi 100% të Bashkim Ulaj.

D. *TV Ora (familja Ndroqi)*

TV Ora operon përmes shoqërisë “ORA” sh.a.. Sipas strukturës së pronësisë, aksioneri i vetëm i “ORA” sh.a. është aktualisht Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK) me 100%. Si “pronarë përfitues” (sipas QKB) janë pasqyruar Ylli Ndroqi (60% direkte) dhe Mimoza Ndroqi (40% direkte).

Ky subjekt ofron shërbim audioviziv rajonal, që sot administrohet nga AAPSK, pas vendimi Nr. 17, datë 03.11.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë, në të cilën u vendos: Konfiksimi i pasurive të subjektit/shtetasit Ylli Ndroqi dhe personit të lidhur me të, shtetasës Mimoza Ndroqi.

V. EKSPLOZIMI I INTERESAVE

Pas “pasaportave” të mediave, ky kapitull kalon nga identifikimi i pronësisë dhe strukturës së operatorëve audiovizivë te një analizë monitoruese e përfitimeve që mund të lidhen me marrëdhënien e subjekteve të lidhura me media me shtetin. Në këtë raport, termi “përfitim” ka kuptim të gjerë dhe përfshin si përfitime financiare (kontrata, tendera, pagesa, transferta), ashtu edhe përfitime rregullatore/administrative (status i posaçëm, procedura të përshpejtuara, përdorim pasurish publike, leje, autorizime, ndryshime rregullash që ndikojnë sektorin e biznesit, etj.). Kjo qasje është e nevojshme sepse, në Shqipëri, ndikimi ekonomik i shtetit ndaj aktorëve privatë nuk shfaqet vetëm përmes pagesave direkte nga buxheti, por shpesh edhe përmes vendimmarrjeve rregullatore me efekt ekonomik të konsiderueshëm (p.sh. status “investitor strategjik”, kontrata përdorimi/shitje të pasurive publike, përfitime të tjera pa konkurim, leje ndërtimi).

Në vijim, kapitulli analitik zbërthen këto pista fillimisht për mediat kombëtare, duke ndjekur të njëjtin standard raportimi.

5.1. Ekspozimi ekonomik, përmes statusit të posaçëm, lehtësimeve dhe aseteve publike

Një nën-pistë e rëndësishme monitorimi është rasti kur subjekte të lidhura me pronarë/pronarë përfitues të mediave përfitojnë status “investitor strategjik”. Ky status nuk përbën shkelje në vetvete, por është indikator që krijon një marrëdhënie materiale me institucionet publike dhe, për rrjedhojë, kërkon transparencë mbi “elementin strategjik”, masat mbështetëse dhe kushtet e miratimit. Në kampionin e analizës, ky indikator shfaqet në forma të ndryshme te familje/grupe pronare të mediave kombëtare.

Një tjetër formë e përfitimit rregullator është përfitimi i pasurive publike në kushte preferenciale me Vendim të Këshillit të Ministrave, pa garë publike, përfshirë përdorimin për një kohë të gjatë të bregdetit. Kjo mënyrë e dhënies në përdorim të bregdetit ndërhyr te interesi i përgjithshëm për shfrytëzimin kolektiv të pasurive publike (si bregdeti), i cili gëzon përparësi absolute ndaj interesit privat për vazhdimësinë tregtare të një subjekti të vetëm. Interesi i përgjithshëm kërkon përcaktimin që të drejtat e shfrytëzimit të jepen ekskluzivisht

vetëm përmes procedurave konkurruese dhe të barabarta për të gjithë operatorët e tregut, ndërsa mekanizmat e zgjatjes automatike të afateve të shfrytëzimit të pasurive shtetërore janë të papajtueshme me parimet thelbësore të tregut të lirë dhe të drejtën e BE, duke e bërë imperative zëvendësimin e tyre me procedura të hapura prokurimi që garantojnë trajtim të barabartë.

Në raport, këto raste trajtohen vetëm mbi bazën e dokumentacionit primar (vendim, kontratë, afat, sipërfaqe, institucion), në mënyrë që evidenca të jetë e standardizuar dhe e verifikueshme.

Në vijim, ky nënkapitull paraqet: (a) kornizën e statusit “investim/investitor strategjik” si përfitim rregullator; (b) një indikator horizontal me rëndësi për marrëdhënien shtet–media (asimetria e politikave kompensuese në sektorin audioviziv) dhe; (c) rastet e evidentuara të interesave ekonomike, të organizuara sipas familjeve/grupeve pronare.

5.1.1. Statusi “Investim/Investitor Strategjik” dhe masat mbështetëse

Statusi “Investim/Investitor Strategjik” parashikohet nga Ligji nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar) dhe synon të nxisë investime të konsideruara me rëndësi në sektorë të përcaktuar si strategjike, përmes një kuadri të posaçëm procedurash dhe koordinimi institucional. Vendimmarrja kryesore kryhet nga Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS), organ kolegjal pranë Këshillit të Ministrave, i kryesuar nga Kryeministri, ndërsa AIDA funksionon si sekretariat/strukturë koordinuese (“one-stop shop”) për ndjekjen ndërinstitucionale të procedurave.

Ligji njih dy rrugë kryesore për dhënien e statusit. Procedurën e asistuar dhe procedurën e veçantë. Vendimi i KIS që miraton statusin duhet të përmbajë elementë bazë si titulli i projektit, vlera e investimit, afatet dhe të dhëna të tjera shoqëruese. Në terma praktikë, përfitimet e statusit lidhen kryesisht me lehtësime dhe mbështetje administrative. Prioritizim të procedurave, koordinim të institucioneve për leje, autorizime, mendime dhe procese të ngjashme, me synim uljen e vonesave dhe rritjen e parashikueshmërisë për investitorin. Në procedurën e asistuar parashikohet një paketë masash lehtësuese (të zbatuara sipas legjislacionit sektorial), përfshirë ndjekje të përsheptuar dhe, sipas rastit, masa mbështetëse që mund të lidhen me infrastrukturë ndihmëse ose vënie në dispozicion të pasurive shtetërore. Procedura e veçantë, ndërkohë, parashikon instrumente më të forta për realizimin e projektit, përfshirë edhe mundësinë e shpronësimit për interes publik, kur plotësohen kushtet ligjore.

Në kuadër të këtij raporti monitorimi mbi median, rëndësia e statusit nuk qëndron te ideja se përfitimi është i paligjshëm “vetvetiu”, por te fakti se ai krijon një marrëdhënie materiale të favorshme ndërmjet shtetit dhe subjekteve (ose personave) të lidhur me pronësinë mediatike. Për këtë arsye, në seksionin vijues evidentohen rastet kur subjekte të lidhura me pronarë/pronarë përfitues të mediave kanë marrë status “investitor strategjik”, duke dokumentuar projektin, llojin e procedurës dhe vendimmarrjen përkatëse (kur është e aksesueshme publikisht në vendime të KIS dhe akte shoqëruese).

Në praktikë, skema e investimeve strategjike, e konceptuar fillimisht si instrument për nxitjen e investimeve, është kritikuar në debat publik si mekanizëm që, në disa raste, është përdorur si rrugë e shkurtër për përfitime private. Kjo bëhet veçanërisht relevante për një raport mbi median kur përfituesit (ose subjektet e lidhura me ta) lidhen me pronësi mediatike, sepse lehtësitë procedurale, akseset në pasuri publike ose mbështetje të tjera mund të shtojnë ekspozimin ekonomik dhe, tërthorazi, të krijojnë rreziqe për pavarësinë editoriale dhe pluralizmin.

Në vijim renditen rastet/mediat ku subjekte të lidhura kanë përfituar statusin “investitor strategjik”. Paralelisht, konstatohet një boshllëk i rëndësishëm transparence: informacioni mbi “elementin strategjik” dhe vlerësimet shoqëruese që i paraprijnë vendimmarrjes nuk bëhet publikë në mënyrë të mjaftueshme. Në këtë drejtim, AIDA, në cilësinë e Sekretariatit Teknik të KIS, ka detyrimin ligjor të përgatisë vlerësimet që ndihmojnë KIS në vendimmarrje. Megjithatë, në rastin e kërkesës për informacion, AIDA refuzoi vënien në dispozicion të këtij dokumentacioni, me arsyetimin se për publikun mjafton vendimi i KIS dhe se dokumentet e saj i shërbejnë vetëm vendimmarrjes së KIS. Ky qëndrim bie ndesh me logjikën e transparencës dhe e vështirëson verifikimin publik të arsytimit që shoqëron dhënien e statusit, duke rritur rrezikun që vendimmarrja të perceptohet si arbitrare ose së paku jo mjaftueshëm e justifikuar.

(A) Familja Hoxha (Top Channel). Projekti “ANIMA”

Me Vendimin nr. 1, datë 10.04.2025, KIS miratoi statusin “Investitor strategjik – procedurë e veçantë” për projektin “ANIMA”, me subjektet aplikues ANIMA CON sh.p.k. (NUIS M21803025R) dhe EB Construction sh.p.k. (NUIS L91619016G). Projekti përshkruhet si kompleks me funksion të përzier (hotel/rezidencial/godina banimi dhe shërbimesh) në Bashkinë Tiranë, me vlerë investimi të raportuar 55.6 milion euro dhe shtrirje në një sipërfaqe rreth 0.96 ha (9,600 m²). Po sipas materialit, ortake e ANIMA CON sh.p.k. rezulton Lorela Hoxha (100%), me kuotë të raportuar si e dhuruar nga Vjollca Hoxha.

(Shënim redaksional: në këtë fazë, ky rast dokumentohet si indikator rregullator. Çdo vlerësim kritik për “elementin strategjik” ose proporcionalitetin e statusit do të përfshihet në kapitullin final të boshllëqeve dhe rekomandimeve, pasi të konsolidohen të gjitha rastet.)

(B) Familja Dulaku – “San Pietro” dhe “Gone Perivol” (Vizion Plus)

Familja Dulaku (përmes Concord Investment) rezulton e lidhur me statusin “investitor strategjik” në 2 projekte turistike/ndërtimore. Në total për dy projektet raportohen plane investimi deri në 120 milion euro.

Projekti “San Pietro”, Qarku Durrës

Ky projekt e fitoi statusin me Vendimin e KIS Nr. 25/2, datë 20.11.2017 për miratimin e statusit strategjik për “Concord Investment” sh.p.k. (NIPT K81602049K), si dhe VKM Nr. 300, datë 10.5.2019 për dhënien e statusit të veçantë “Investitor në strukturë akomoduese me 5 vje, status special”. Më tej, Vendimi i KKT Nr. 13, datë 28.02.2020 rishikoi kushtet e lejes së ndërtimit të kompleksit “San Pietro”, duke shtyrë afatin dhe u morën masa mbështetëse për përdorimin e brigjeve/zonës së plazhit, përmes VKM nr. 519, datë 01.08.2024 dhe kontratës me Bashkinë Durrës. Pesë vjet më vonë, me Vendimin nr. 8, datë 15.07.2025, u morën masa mbështetëse duke u vënë në dispozicion të një sipërfaqeje shtetërore rreth 1 Ha, në funksion të projektit.

Projekti “Gone Perivol” (Dhërmi)

Për projektin “Gone Perivol”, KIS ka miratuar statusin “Investim strategjik me procedurë të asistuar” me Vendimin nr. 24/2, datë 20.11.2017, për një periudhë 3-vjeçare, me subjekt

aplikues Concord Investment sh.p.k. Vendimi reflekton edhe logjikën e masave mbështetëse (prioritet/afate të përshpejtuara dhe asistencë për leje/licenca/autorizime), si dhe parashikon që përdorimi i brigjeve/zonës së plazhit dhe çmimet respektive të vendosen me Bashkinë Himarë sipas vendimeve të Këshillit Bashkiak.

Për elementin financiar, në materiale publike dhe profile të subjekteve raportohet vlera e investimit rreth 32–32.5 milion euro për këtë projekt.

Në dhjetor 2023 ky projekt ka pësuar ndryshime.

(C) Familja Frangaj–Gina – investime strategjike dhe pasuri publike (TV Klan)

Projekti “White Roads Hotel”, status strategjik, shtesa sipërfaqesh dhe masa për përdorim të bregdetit.

Me Vendimin Nr. 1/6, datë 05.04.2022, KIS miratoi statusin e investimit strategjik për projektin “White Roads Hotel”, me subjekt White Roads Hotel sh.p.k. (NUIS M02407023J), i shoqëruar me vënie në dispozicion të një sipërfaqeje rreth 9,157 m² tokë shtetërore. Në të njëjtin vendim theksohet afërsia me Monumentin Natyror “Delta e Përroit të Palasës” dhe argumentohet se, për shkak të formave të menaxhimit në kufi të monumentit, masa mbështetëse për përdorimin e brigjeve të detit/zonës së plazhit nuk mund të miratohej me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

Skema “1 euro” dhe formalizimi kontraktual (shtator–tetor 2022)

Pas statusit strategjik, përfitimi rregullator formalizohet me VKM Nr. 593, datë 07.09.2022, e cila miraton lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën “1 euro” ndërmjet ministrisë përgjegjëse për ekonominë dhe shoqërisë “White Roads Hotel” sh.p.k.

VKM ka një bazë ligjore të paqartë nga ana ligjore pasi bazohet në Aktin Normativ nr. 4, datë 9.7.2008, i cili nuk ka në objektin e vet shitje të tokës pronë publike/shtetërore.

Në 2023 KIS miratoi shtesa sipërfaqesh (përfshirë rreth 22,000 m²) dhe u reflektua një qasje “me kushte” për aspektin mjedisor (mos-cenim i monumentit, mos-shtrirje e linjave infrastrukturore në territorin e tij, brez i gjelbër dhe monitorim nga AdZM Vlorë). Për përdorimin e brigjeve/zonës së plazhit, nga ndalimi u bë delegimi te Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për përcaktimin e sipërfaqeve dhe regjimit ligjor.

Me VKM Nr. 770, datë 13.12.2024, u miratuan shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 593, ku projekti përfitoi edhe 21,979.4 m² tokë shtesë.

Në një fazë të mëvonshme, subjekti kërkoi saktësim/unifikim të koordinatave të plazhit. KIS, me Vendimin Nr. 9, datë 15.07.2025, miratoi masën mbështetëse të vënies në dispozicion të bregut të detit (neni 29 i Ligjit nr. 55/2015), sipas koordinatave të hartave shoqëruese, ndërsa Aneksi nr. 2 nuk është i publikuar. Vendimi parashikon ekzekutimin e masës përmes marrëveshjes me AKB pas vënies në funksion të strukturës akomoduese, ndërsa tarifa përcaktohet me vendim të Këshillit Bashkiak.

Në prill 2025 Aleksandër Frangaj (i lidhur me TV Klan) mori pronësinë e hotelit, ndërsa projekti kishte marrë më herët statusin strategjik nën aplikimin e shoqërisë “Gjiguria” sh.p.k. Ky tranzicion mbetet me interes monitorimi edhe sepse çmimi/kushtet e shitjes së kuotave nuk rezultojnë

të publikuara. Sugjerohet verifikim për marrëdhënie paraprake/interesa të ndërthurura, duke referuar bashkë-investimin e raportuar Gjiguria–Golden Key në “Drymades Villas”.

“Green Coast”. Status strategjik dhe masa mbështetëse

Projekti “Green Coast” është një tjetër investim strategjik me masa mbështetëse rregullatore dhe përdorim të aseteve publike. Statusi strategjik është miratuar me Vendim të KIS Nr. 2/13, datë 14.07.2016 (afat 4-vjeçar). Projekti është pajisur me Leje Zhvillimore Komplekse (Nr. Prot. 2385/2, datë 27.04.2015), e lidhur me Vendimin e KKT Nr. 8, datë 07.03.2014, dhe më pas me Leje Ndërtimi sipas Vendimit të KKT Nr. 13, datë 12.04.2017 (rishikim kushtesh dhe shtesë në sipërfaqe).

Paketa e masave mbështetëse, përfshin procedura prioritare dhe afate të përshpejtuara, asistencë për leje/licenca/autorizime, si dhe në parim konsolidim toke/ndryshim destinacioni dhe vënie në dispozicion të pasurisë shtetërore në ZK 1739, Dhrale, Bashkia Himarë (në zbatim të Ligjit nr. 55/2015). Në të njëjtën linjë, parashikohet edhe masa për përdorimin e brigjeve të detit/zonës së plazhit përballë kompleksit, “në parim” deri në 30 vjet, me koordinata të përcaktuara dhe me referencë të VKM Nr. 544, datë 27.07.2016 (e ndryshuar).

Ndërsa me Vendimin nr 476, dt 13.07. 2022, u miratua kalimi i pasurive me sipërfaqe totale 8 774 m² të ndodhura në Palasë, Himarë nga pronë shtetërore në pronë private për shoqërinë “Green Coast”.

Në përfundim mund të themi se në praktikë, masa si statusi “investitor strategjik” dhe paketa e masave mbështetëse (procedura prioritare, asistencë ndër-institucionale, konsolidim toke/ndryshim destinacioni, vënie në dispozicion të pasurive shtetërore, përdorim afatgjatë i brigjeve/zonës së plazhit) krijojnë një marrëdhënie të strukturuar ndërmjet subjektit privat dhe institucioneve publike. Kjo marrëdhënie është e ndryshme nga një marrëdhënie thjesht tregtare: ajo varet nga vendimmarrje administrative, nga interpretimi i kriterëve (elementit strategjik), nga kushte të posaçme dhe, në disa raste, nga përdorimi i aseteve publike me vlerë të lartë ekonomike (si tokat, bregdeti, zonat e plazhit). Për këtë arsye, ky raport e trajton këtë tipologji si indikator të rëndësishëm për transparencën dhe llogaridhënien.

Për të mbajtur analizën në një standard verifikueshmërie, kërkuam nga AIDA të njiheshim me raportin e vlerësimit të elementit strategjik për projektet e mësipërme, dokumentacion që u refuzua me justifikimin nuk ka interes për publikun ky dokumentacion por vetëm për organin që vendos, Komitetin e Investimeve Strategjike.

Indikatorët, transparenca e të cilëve do të ndihmonte nxjerrjen e konkluzioneve për arbitraritet apo ndershmëri në vendimmarrje do të ishin:

1. *Elementi strategjik.* Cili është argumentimi i dokumentuar që e bën projektin “strategjik” (jo vetëm deklarami)? A ekzistojnë dokumentet paraprake të vlerësimit (vlerësim paraprak; vlerësim teknik/financiar/ligjor)?
2. *Proporcionaliteti.* A është masa mbështetëse proporcionale me synimin e deklaruar dhe me interesin publik të projektit (p.sh. turizëm/akomodim)?
3. *Ndikimi mjedisor dhe kushtëzimet.* Si reflektohen kushtet mjedisore (leje mjedisore, monitorim, ndalime të shtrirjes infrastrukturore) dhe a janë të dokumentuara e të zbatueshme?
4. *Lidhjet me pronësinë mediatike.* A janë të qarta hallkat e pronësisë, kur subjekti përfitues lidhet me pronarë medias, dhe a ekziston një transparencë e mjaftueshme për të shmangur konfliktet e interesit?

Në përfundim, kjo analizë e ndikimit synon të vendosë një standard të qartë. Duke përsëritur se raporti nuk barazon përfitimin rregullator me ndikim editorial, por e trajton atë si ekspozim që kërkon transparencë të shtuar, dokumentim të plotë dhe arsyetim publik.

5.1.2 Asimetria e politikave kompensuese të shtetit dhe e trajtimeve preferenciale për disa media

Në vijim të ekspozimit ekonomik përmes statusit të posaçëm, lehtësimeve dhe aseteve publike, një dimension tjetër, po aq i prekshëm për perceptimin e pavarësisë është mbështetja financiare direkte e sektorit audioviziv nga shteti, veçanërisht kur lidhet me tranzicione teknologjike dhe menaxhimin e spektrit të frekuencave. Dy episode të ndara në kohë, VKM nr. 240/2019 “Për miratimin e kriterëve për ndarjen e kompensimit financiar të operatorëve me eksperiencë në transmetimet numerike dhe operatorëve privatë historikë kombëtarë“, ligji nr. 34/2017 dhe projektligji i vitit 2025 për lirimin e brezit 700 MHz, e bëjnë këtë ndërveprim të dukshëm dhe të matshëm, duke ngritur pyetjen nëse politikat kompensuese funksionojnë në mënyrë simetrike në treg dhe sa të forta janë garancitë e transparencës.

(1) VKM nr. 240, datë 04.04.2019 – kompensimi për digjitalizimin/digjital-dividentin.

VKM nr. 240/2019 miratoi kriteret për një skemë kompensimi të lidhur me kalimin në transmetimet numerike dhe lirimin e frekuencave të digjital-dividentit. Vendimi parashikon një fond total prej 4 milionë euro, të ndarë në dy komponentë. Komponenti i parë 2 milionë euro për “operatorët me eksperiencë në transmetimet numerike” (që janë Digit-Alb dhe Tring i operuar në atë kohë nga Mediavizion) dhe 2 milionë euro për “operatorët privatë historikë kombëtarë” që përfshin Tv Klan, Top Channel dhe Vizion Plus. Skema e lidh përfitimin me dokumentimin dhe verifikimin administrativ, ku AMA luan rol kyç në shqyrtimin e dokumentacionit dhe kryerjen e pagesës pas plotësimit të kërkesave. Në zbatim, AMA ka nxjerrë vendimmarrje të posaçme për përcaktimin e operatorëve të përfshirë në skemë, çka e bën të qartë se kompensimi lidhet me një grup të kufizuar operatorësh të segmentit kombëtar.

Në leximin e politikës publike, kjo mund të kuptohet si masë korigjuese, ku shteti kompenson pjesërisht një kosto të imponuar nga vendimmarrja rregullatore dhe nga tranzicioni teknologjik, për të ruajtur vazhdimësinë e shërbimit. Por për një raport monitorimi mbi ekspozimin ekonomik të medias, rëndësia qëndron te efekti strukturor. Një transferim i drejtpërdrejtë financiar drejt një segmenti të ngushtë të tregut audioviziv, në një sektor me ndikim të veçantë në informimin e publikut.

(2) Ligji nr. 34/2017 dhe projektligji 2025. Kompensimet financiare për lirimin e frekuencave të Digjital Dividentit

Skemat e kompensimit financiar në sektorin audioviziv nuk lindin me projektligjin e vitit 2025. Ato kanë pararendës ligjin nr. 34/2017, “Për lirimin e frekuencave të dixhital-dividentit”, i lidhur me kalimin nga transmetimet analoge në numerike dhe lirimin e brezit 790–862 MHz për rrjetet e komunikimeve të lëvizshme. Ky ligj parashikonte kompensim financiar për mbulimin e pjesshëm të kostove neto shtesë të tranzicionit teknologjik, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së marrjes së programeve televizive nga publiku.

Ligji nr. 34/2017 është i rëndësishëm sepse e lidhte kompensimin me arkitekturën e licencimit digjital dhe procesin “Beauty Contest”, duke përfshirë si përfitues “operatorët

privatë historikë kombëtarë” dhe “operatorët me eksperiencë në transmetimet numerike”. Ai parashikonte një fond kompensimi minimalisht prej 5 milionë euro, të financuar nga të ardhurat e autorizimeve për përdorimin e frekuencave DD1, me kufirin që fondi të mos tejkalonte 10% të vlerës së arkëtueshme.

Kompensimi ndahet në tre drejtime: 1/5 për mbështetjen e operatorëve lokalë/rajonale në rrjetet numerike; 2/5 për investimet e operatorëve me eksperiencë në transmetime numerike që dilnin jashtë funksionit nga ndryshimet teknologjike; dhe 2/5 për operatorët privatë historikë kombëtarë për kalimin nga infrastruktura analoge në numerike. Ndarja e detajuar bëhet me VKM, mbi propozimin e AMA-s, duke respektuar objektivitetin, proporcionalitetin dhe mosdiskriminimin.

Në vitin 2025, qeveria ka hedhur për konsultim një projektligj të ri që parashikon 5.1 milionë euro kompensim për lirim të vonuar të brezit 700 MHz. Sipas materialit të raportuar, kompensimi ndahet mes RTSH, TV Klan, Top Channel, DigitAlb, ADTN dhe Media Vizion, me pagesë në dy këste nga 50%, në fillim dhe në përfundim të procesit.

Arsyetimi publik i këtyre skemave është i kuptueshëm: migrimi i frekuencave dhe rikonfigurimi teknik i rrjeteve mund të sjellin kosto reale dhe rrezik ndërprerjesh ose ulje mbulimi. Në këtë kuptim, si ligji nr. 34/2017, ashtu edhe projektligji i vitit 2025, paraqiten si instrumente për të garantuar vazhdimësinë e shërbimit audioviziv.

Megjithatë, për efekt monitorimi, këto skema tregojnë se tranzicioni teknologjik është shoqëruar jo vetëm me vendimmarrje rregulatore për frekuencat dhe rrjetet, por edhe me kompensime financiare për aktorët kryesorë të tregut. Ndryshe nga ligji nr. 34/2017, ku përfshiheshin edhe operatorët lokalë/rajonale, projektligji i vitit 2025 duket më i përqendruar te operatorët kombëtarë të rrjeteve numerike dhe operatori publik, ndërsa ndikimi për mediat lokale mbetet kryesisht indirekt.

Krahasuar me sektorë të tjerë privatë, ku kostot rregulatore zakonisht trajtohen si kosto pajtueshmërie, kompensimet e drejtpërdrejta në sektorin audioviziv krijojnë një asimetri të dukshme. Kjo nuk provon trajtim preferencial ose ndikim editorial, por ngre pyetjen se çfarë garancish transparence, auditimi, proporcionaliteti dhe mosdiskriminimi duhen për të shmangur perceptimin e një avantazhi të pamërituar në treg.

Për këtë arsye, raporti i trajton këto skema jo si prova ndikimi editorial, por si indikatorë ekspozimi ekonomik që rrisin ndërveprimin shtet–media. Ato lidhen drejtpërdrejt me procesin “Beauty Contest”: shteti ka përcaktuar kush fiton akses në infrastrukturën kryesore të transmetimit numerik dhe, në faza të ndryshme, ka parashikuar edhe kompensime financiare për kostot e kësaj arkitekture. Ky kombinim e bën të nevojshme analizën e mënyrës se si u organizua procesi “Beauty Contest” dhe efektet e tij në strukturën e tregut mediatik.

(3) Procesi “Beauty Contest” dhe alokimi i licencave digjitale kombëtare

Procesi i dhënies së licencave për transmetimet digjitale tokësore në Shqipëri, i njohur si “Beauty Contest”, ishte një nga momentet kryesore të ndërveprimit shtet–media gjatë tranzicionit drejt digjitalizimit. I administruar nga AMA, ai synonte përzgjedhjen e operatorëve që do të kontrollonin aksesin në rrjetet numerike tokësore, një burim i kufizuar dhe strategjik për shpërndarjen e përmbajtjes audiovizive.

Në maj 2015, AMA hapi garën për 5 licenca private kombëtare të transmetimit audioviziv numerik, krahas rrjeteve të RTSH-së. Për aplikim u ftuan TV Klan sh.a., Top Channel sh.a., Digit-Alb sh.a., Tring TV sh.a. dhe Supersport sh.a. Licencat përfshinin shërbimet programore, si dhe ndërtimin e operimin e rrjeteve tokësore numerike kombëtare në brezat 470–790 MHz, me teknologji DVB-T2 dhe standard MPEG-4.

Procesi pati bllokime. Më 1 shkurt 2016, AMA vendosi mosdhënien e disa licencave, pasi nuk u arrit kuorumi prej pesë votash. Më pas, pas kontestimeve gjyqësore, në mars 2016 AMA u detyrua të jepte tre licenca për Digit-Alb, Top Channel dhe TV Klan. Në dhjetor 2016 u dha licenca e katërt për Media Vizion/Vizion Plus, ndërsa në janar 2017 licenca e pestë iu dha ADTN, shoqëri e lidhur me Digit-Alb.

Në praktikë, arkitektura e transmetimit numerik kombëtar u përqendrua rreth RTSH-së dhe operatorëve privatë Top Channel, TV Klan, Digit-Alb, Media Vizion/Vizion Plus dhe ADTN. Kjo është e rëndësishme sepse licenca nuk ishte vetëm autorizim teknik, por instrument që përcaktonte kontrollin mbi infrastrukturën kryesore të shpërndarjes së sinjalit televiziv kombëtar.

Në këtë kontekst, rasti Agon Channel/Francesco Becchetti është ilustrues. Subjekti i lidhur me këtë media u ankua deri në GJEDNJ për pamundësinë për të marrë pjesë në procedurën “Beauty Contest” për një licencë kombëtare digjitale. Në vitin 2022, kërkesa u rrëzua si e papranueshme, por rasti mbetet tregues i ndikimit që proceset rregullatore mund të kenë mbi hyrjen ose përjashtimin nga tregu.

Nga këndvështrimi i politikës publike, “Beauty Contest” është instrument për alokimin e burimeve të kufizuara, si frekuencat, mbi bazën e kriterëve teknike, ekonomike dhe interesit publik. Por në një treg të vogël e të përqendruar si ai shqiptar, rezultati i tij ka edhe efekt strukturor: përjashtimi nga aksesin në rrjetet tokësore digjitale mund të kufizojë drejtpërdrejt aftësinë e një mediaje për të konkurruar.

Kritikat ndaj procesit u përqendruan te vonesat dhe bllokimet institucionale, konfliktet e mundshme të interesit, ndikimi mbi përqendrimin e pronësisë dhe mungesa e mekanizmave të mjaftueshëm për mbrojtjen e pluralizmit. Në fund, pesë licencat digjitale përfunduan në duart e tre grupeve kryesore pronësore: familja Hoxha përmes Digit-Alb, Top Channel dhe ADTN; familja Frangaj përmes TV Klan; dhe familja Dulaku përmes Media Vizion/Vizion Plus. Edhe OSBE kishte paralajmëruar më herët për ndikimin afatgjatë të ndryshimeve ligjore dhe licencimit digjital mbi pluralizmin mediatic.

Ky raport nuk e trajton “Beauty Contest” ose rastin Agon Channel si vlerësim përfundimtar mbi ligjshmërinë e vendimmarrjeve konkrete, por si indikatorë të ndërveprimit ndërmjet medias, tregut dhe autoritetit rregullator. Ato tregojnë se aksesin në infrastrukturën e transmetimit nuk është neutral ekonomikisht; vendimmarrjet publike mund të përcaktojnë hyrjen ose daljen nga tregu; përqendrimi i licencave në pak grupe mund të ketë efekte afatgjata mbi pluralizmin; dhe mungesa e transparencës mund të çojë në kontestime të gjata ligjore.

Krahasuar me kompensimet financiare për digjitalizimin, “Beauty Contest” është një formë më pak e dukshme, por potencialisht shumë e fuqishme ndërhyrjeje. Ajo nuk transferon fonde, por alokon akses në një burim esencial për aktivitetin mediatic. Për këtë arsye, mënyra e organizimit, kriteret e vlerësimit, pavarësia e AMA-s dhe transparenca janë thelbësore për të garantuar konkurrencë, pluralizëm dhe shmangie të perceptimeve për favorizim ose përjashtim selektiv.

5.1.3. Ekspozimi ekonomik përmes interesave tregtare dhe sektorëve të rregulluar

Ky nënseksion e trajton rrezikun e ndikimit jo si investigim rast për rast, por si profil sasior i ekspozimit rregullator. Sa i gjerë është portofoli i interesave të lidhura me një media kombëtare dhe sa prej këtyre interesave varen nga vendimmarrje publike (leje ndërtimi/kalim pasurie publike, etj). Qëllimi është të kuptohet pesha e varësisë nga lejet, dhe jo të inventarizohen të gjitha pronat ose projektet.

A. MEDIAT KOMBËTARE

1. FAMILJA FRANGAJ (TV KLAN)

Rrjeti familjar Frangaj - Gina paraqitet si një konfigurim ku bërthama mediatike TV Klan bashkëjeton me një shtrirje të gjerë interesash në sektorë ku vlera ekonomike krijohet shpesh përmes lejeve, ndryshimeve të projekteve, përdorimit të aseteve publike dhe statuseve të posaçme. Në këtë profil, “mundësia e ndikimit” argumentohet me një logjikë faktike, me projekte të mëdha turistike/zhvillimore, përfshirje në mekanizma rregullatorë me peshë (investime strategjike, skema “1 euro/kontrata”, përdorim brigesh/zonë plazhi, pasuri shtetërore), dhe gjurmë të matshme ekspozimi financiar në periudha të ndryshme. Ky rrjet numëron mbi 30 shoqëri tregtare të lidhur në formë pronësie direkte dhe indirekte.

Përdorimi i aseteve me origjinë publike

Një kanal i ekspozimit ekonomik për familjen Frangaj-Gina lidhet me përdorimin e aseteve me origjinë publike dhe me shfrytëzimin e hapësirave që kanë vlerë të lartë ekonomike për shkak të vendndodhjes dhe potencialit zhvillimor, si zona e njohur si ish-Kinostudio. Në burime të monitorimit të pronësisë së medias, TV Klan referohet si i vendosur “pranë ish-Kinostudios”, duke e bërë këtë zonë një pikë relevante për monitorim në kuptimin e marrëdhënieve me pasuri/ambiente me status publik. Paralelisht, në media janë publikuar pretendime mbi përfitime/pronësi ose zhvillime në zonën e ish-Kinostudios të lidhura me rrjetin përreth TV Klan. Për efekt të këtij raporti, këto trajtohen si pistë verifikimi që kërkon dokumente primare (titulli i së drejtës, baza ligjore e fitimit/përdorimit, kontrata qiraje/përdorimi nëse ka, aktet e privatizimit/kthimit/kompensimit, si edhe lejet e zhvillimit/ndërtimit dhe ndryshimet e tyre). Transparenca mbi këto elemente është e rëndësishme sepse përdorimi i aseteve të tilla mund të ketë efekt të drejtpërdrejtë konkurrues dhe të ndikojë në perceptimin publik për trajtime preferenciale.

Projekte turistike me status/masa mbështetëse dhe pasuri publike

Një rast kyç është “White Roads Hotel / Delta Gardens”, që ilustron përfitimin kryesisht përmes masave rregullatore, ku në faza të ndryshme janë vënë në dispozicion sipërfaqe publike prej 9,157 m², të ndjekura nga shtesa toke prej 22,000 m² dhe 21,979 m². Në të njëjtin rast evidentohet edhe afërsia me Monumentin Natyror “Delta e Përroit të Palasës” dhe mënyra si trajtohet elementi mjedisor në faza të ndryshme të vendimmarrjes.

Një projekt tjetër madhor është “Green Coast” në Palasë/Dhërmi. Kompleksi turistik shtrihet në 217,659 m² me sipërfaqe ndërtimi 73,138 m², ndërsa hoteli me 5 yje “White Sensation” parashikon trull 10,600 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 8,175 m². Për këto projekte

evidentohet edhe përdorimi i masave mbështetëse tipike për investime strategjike (prioritet procedurash dhe asistencë për leje/autorizime), të trajtuara më herët në raport.

Projekte urbane me ndërtesa të larta (kulla/polifunktionale)

Në portofolin e rrjetit familjar Frangaj - Gina evidentohen edhe projekte urbane të tipologjisë ndërtesa të larta / komplekse multifunktionale, ku përfitimi ekonomik lidhet ngushtë me lejet, ndryshimet e projektit dhe kushtet e zhvillimit urban. Këtu përfshihen zhvillime të tilla si Media City (zonë multifunktionale me kullë deri në 34 kate me 54 mijë m² ndërtim dhe rreth 400 apartamente, si edhe projekte të tjera të portofolit urban si Tirana West Center, kompleks multifunksional në Kashar me ndërtesa deri në 27 kate dhe Tirana Tower, të cilat ilustrojnë shtrirjen e interesave në zhvillim urban me intensitet të lartë rregullimi.

Projekte turistike dhe “fshatra turistike” (bregdet/resorte)

Paralelisht, pjesa më e madhe e profilit lidhet me projekte në turizëm dhe zhvillime bregdetare, ku vendimmarrja publike ka peshë të drejtpërdrejtë për shkak të lejeve, statusit, përdorimit të asetëve publike dhe regjimit të zonave të mbrojtura/brigjeve. Shembuj të qartë përveç projekteve strategjike White Roads, dhe kompleksi Green Coast, shfaqen edhe hoteli me 5 yje White Sensation, me truall 10,600 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 8,175 m². Në të njëjtën linjë janë edhe projekte të tjera turistike të lidhura si Drymades Villas, me sipërfaqe ndërtimi 14,291 m² dhe Sun Palasë, si pjesë e portofolit zhvillimor bregdetar; Projekti “Astoria”, rezidencë vilash në Mjull-Bathore; projekti “The Wall”, kompleks rezidencial dhe shërbime me ndërtesa disa-katëshe; projekte në bregdetin e Vlorës si “Vlora Waterfront Towers”, “Vlora Central” dhe “Vlora Beach West”.

Gjurmë ekspozimi financiar nga fondet publike

Për rrjetin familjar Frangaj - Gina, ekspozimi financiar që rezulton nga transaksionet e thesarit janë: Për White Roads Hotel raportohen 3 transaksione në periudhën 2019–2026 me vlerë 359,402,286 lekë; për TV Klan, evidentohet një rritje e volumit: nga 1,400,000 lekë në vitet 2015–2018 në 43,706,079 lekë për vitet 2019–2026. Për një shoqëri tjetër të lidhur me rrjetin, EBG Group, evidentohet ekspozim me shumë transaksione dhe vlera të konsiderueshme në periudhën 2019–2026 që shënon 45,998,834 lekë. Për Anchor Investments evidentohet gjithashtu një përfitim i raportuar prej 1,925,520 lekë (2019–2026).

Në termat e raportit, profili Frangaj–Gina trajtohet si rast studimi jo sepse “prodhon” automatikisht ndikim editorial, por sepse ndërthur tre elemente që rrisin ekspozimin rregullator. Media kombëtare me peshë me portofol projektësh në turizëm/ndërtim ku vendimmarrja publike është determinante (White Roads/Delta Gardens; Green Coast; White Sensation; Drymades Villas; Sun Palasë; Green Coast II; Tirana West Center; Tirana Tower; Media City); dhe gjurmë të matshme ekspozimi financiar në periudha të ndryshme. Ky kombinim rrit nevojën që marrëdhëniet ekonomike të dokumentohen me standard më të lartë transparence, për të minimizuar konfliktet e mundshme të interesit dhe për të mbrojtur konkurrencën e ndershme në tregun mediatik.

Raportime mediatike mbi çështjen “Laguna Blu” dhe lidhjet e mundshme mes interesave private të familjes Frangaj dhe TV Klan

Sipas raportimeve të publikuara në media dhe burimeve monitoruese për pronësinë e medias, familja Frangaj–Gina është identifikuar si zotëruese e TV Klan, një prej televizioneve kryesore kombëtare në Shqipëri. Familja raportohet të ketë pjesëmarrje edhe në media të tjera si ABC News.

Në këtë kontekst, një rasti i njohur publikisht si “Laguna Blu” është përmendur në një sërë raportimesh mediatike të vitit 2015 si një episod ku interesat private të një pronari të rëndësishëm mediatik u ndërthurën me debat publik mbi përdorimin e një hapësire turistike dhe rekreative në zonën e Qerretit. Sipas Balkanweb, bashkëpronarë të kompleksit “Laguna Blu” i janë drejtuar autoriteteve shtetërore me një peticion, ku kundërshtonin ndërhyrjet në kompleks dhe pretendonin se zona rekreative e sportive ishte pjesë e planit fillestar të zhvillimit të resortit.

Raportime të tjera mediatike kanë trajtuar çështjen në aspektin e vlefshmërisë së dokumenteve, marrëdhënieve kontraktore dhe statusit të sipërfaqes ku pretendohet ndërtimi. Gazeta Tema, në një material të titulluar si “dossier”, përmend një kontratë sipërmarrjeje dhe akt-marrëveshje midis Epidam sh.p.k. dhe Aleksandër Frangaj/Alba Gina, duke ngritur pretendime mbi vlefshmërinë formale të dokumenteve dhe mbi destinacionin e sipërfaqes së përdorur si terren sportiv. Ndërsa Shqiptarja.com ka publikuar qëndrimin e A.V., i paraqitur si fitues i koncesionit të zhvillimit të zonës, sipas të cilit terrenet sportive nuk mund të tjetërsoheshin për ndërtim, pasi sipërfaqja e ndërtimit ishte e përcaktuar në lejen fillestare të zhvillimit.

Nëse këto raportime lexohen në kuadrin e analizës së pluralizmit mediatik, çështja nuk qëndron vetëm te debati pronësor ose urbanistik në vetvete, por te perceptimi publik që krijohet kur emiri i një pronari të rëndësishëm mediatik përfshihet në një dyshim për konflikt me interes ekonomik privat dhe, njëkohësisht, zotëron një kanal me ndikim të konsiderueshëm në formësimin e opinionit publik. Në këtë kuptim, “Laguna Blu” mund të trajtohet si një rast ilustrues për rrezikun e ndërthurjes së interesave mediatike, ekonomike dhe politike, sidomos kur transparencja mbi lidhjet e pronësisë, përfitimet ekonomike dhe linjat editoriale mbetet e kufizuar.

Përmendje e rastit “Laguna Blu” gjendet te Freedom House, në raportin Nations in Transit 2016, ku thuhet se interesat private dhe politike vijonin të dominonin median, “siç ilustrohet” nga rasti i ashtuquajtur “Blue Lagoon”.

Për rrjedhojë, në raport ky rast mund të paraqitet jo si konkluzion përfundimtar mbi konfirmimin dhe paligjshmërinë e veprimeve apo mbi ndikimin editorial konkret të TV Klan, por si një episod i rëndësishëm i debatit publik mbi rrezikun e konfliktit të interesit në media. Raportimet mbi “Laguna Blu”, të lexuara së bashku me të dhënat mbi pronësinë e TV Klan dhe me shqetësimet ndërkombëtare për ndikimin e interesave politike e ekonomike mbi median shqiptare, e bëjnë këtë rast të vlefshëm për analizën e marrëdhënies ndërmjet pronësisë mediatike, interesave private dhe pavarësisë editoriale.



FAMILJA FRANGAJ – GINA

Rrjeti familjar me bërthamë mediatike **TV Klan**



Mbi 30 shoqëri tregtare të lidhura drejtpërdrejt dhe tërthorazi



Bërthama mediatike:
TV Klan – media kombëtare me ndikim të gjerë publik



Profili:

- media kombëtare me peshe
- portofol projektesh në sektorë të rregulluar
- gjurmë të matshme ekspozimi financiar publik



Pikë relevante për monitorim:
përdorimi i asetëve me origjinë publike, përfshirë zonën pranë ish-Kinostudios, me nevojë për verifikim dokumentesh primare

PORTOFOLI I PROJEKTEVE

A



PËRDORIMI I ASETËVE ME ORIGJINË PUBLIKE

- Zona e ish-Kinostudios (Tiranë)
- TV Klan referohet si i vendosur "pranë ish-Kinostudios"
- Raportime mediatike mbi përfitime / pronësi / zhvillime në këtë zonë
- Pistë verifikimi që kërkon dokumente primare

B



PROJEKTE TURISTIKE ME STATUS / MASA MBËSHTETËSE

- | | | |
|--|---|---|
| White Roads Hotel / Delta Gardens | Green Coast – Palasë/Dhërmi | White Sensation (hotel 5 yje) |
| <ul style="list-style-type: none"> • 9,157 m² sipërfaqe publike • +22,000 m² shtesë toke • +21,979 m² shtesë toke • Afërsi me Monumentin Natyror "Delta e Përroit të Palasës" | <ul style="list-style-type: none"> • Sipërfaqe e përgjithshme: 217,659 m² • Sipërfaqe ndërtimi: 73,138 m² | <ul style="list-style-type: none"> • Truall: 10,600 m² • Sipërfaqe ndërtimi: 8,175 m² |

• Përfitojnë masa mbështetëse tipike për investime strategjike (prioritet procedurash, asistencë për leje/autorizime).

C



PROJEKTE URBANE ME NDËRTESA TË LARTA

- | | | |
|---------------------------|---|---|
| Media City | <ul style="list-style-type: none"> • Zonë multifunkionale • Kullë deri në 34 kate | <ul style="list-style-type: none"> • 54,000 m² ndërtim • Rreth 400 apartamente |
| Tirana West Center | <ul style="list-style-type: none"> • Kompleks multifunksional në Kashar | <ul style="list-style-type: none"> • Ndërtesa deri në 27 kate |
| Tirana Tower | <ul style="list-style-type: none"> • Zhvillim urban me intensitet të lartë rregullimi | |

• Përfitimi ekonomik lidhet ngushtë me lejet, ndryshimet e projektit dhe kushtet e zhvillimit urban.

D



PROJEKTE TURISTIKE DHE "FSHATRA TURISTIKË" (BREGDET / RESORTE)

- | | |
|---|---|
| <ul style="list-style-type: none"> • White Roads / Delta Gardens • Green Coast • White Sensation • Drymades Villas (14,291 m² ndërtim) • Sun Palasë • Green Coast II | <ul style="list-style-type: none"> • Astoria (rezidencë vilash, Mjull-Bathore) • The Wall (kompleks rezidencial dhe shërbime) • Vlora Waterfront Towers • Vlora Central • Vlora Beach West |
|---|---|



• Vendimmarrja publike ka peshë të drejtpërdrejtë për leje, status, përdorim asetesh publike, zona të mbrojtura dhe regjimin e zonave të mbrojtura bregdetare.

GJURMË EKSPOZIMI FINANCIAR NGA FONDET PUBLIKE (2019–2026)



White Roads Hotel
3 transaksione
359,402,286 lekë



TV Klan
nga 1,400,000 lekë (2015–2018)
në **43,706,079** lekë (2019–2026)



EBG Group
45,998,834 lekë



Anchor Investments
1,925,520 lekë

RAPORTIME MEDIATIKE: "LAGUNA BLU" DHE LIDHJET FAMILJARE

1



Raportime mediatike për ndryshime statusi të zonës dhe përfshirje të subjekteve të lidhura me familjen Frangaj.

2



Pretendime për ndikim në vendimmarrjen publike; kërkon verifikim me vendime, leje, kontrata dhe dokumente primare.

3



Rasti trajtohet si pistë verifikimi në kuptimin e konfliktit të mundshëm të interesit dhe ndikimit në konkurrencë.

2. FAMILJA HOXHA (TOP CHANNEL)

Përdorimi i aseteve me origjinë publike

Një kanal ekspozimi ekonomik për Top Channel ka qenë i lidhur me përdorimin e pasurive publike, si rasti i Piramidës, e pozicionuar në një hapësirë urbane me vlerë të lartë në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit”. Nëse përdorimi i pasurive të tilla shoqërohet me tarifa simbolike ose kushte preferenciale, kjo marrëdhënie me shtetin mund të ketë edhe efekt të drejtpërdrejtë konkurrues. Për këtë arsye, raporti e konsideron thelbësore transparencën minimale të kontratave të ngjashme të përdorimit/qirasë dhe rekomandon që ato të jenë të aksesueshme publikisht të paktën në elementët bazë: përfituesi, afati, tarifa, baza ligjore dhe qëllimi i përdorimit.

Indikatorë të tjerë të ekspozimit shtet–media

Paralelisht me këtë dimension “jo cash”, profili bëhet më i rëndësishëm për monitorim edhe për shkak të indikatorëve të matshëm të ekspozimit financiar: familja Hoxha rezulton aksionere me rreth 61% në DigitAlb, ndërsa për këtë shoqëri evidentohen përfitime nga buxheti i shtetit në dy periudha (8,108,349 lekë për 2015–2018 dhe 12,037,600 lekë për 2019–2026). Po ashtu, familjarë rezultojnë ortakë në Valtelina sh.p.k. dhe pjesëmarrës në shoqëri të tjera si Video Grafic Agency sh.p.k., të lidhura me fushën e shërbimeve/komunikimit.

Në të njëjtën linjë, për Top Channel si media kryesore audiovizive e lidhur me familjen Hoxha, të dhënat e transaksioneve në thesar evidentojnë volum të konsiderueshëm ndër vite: 50,115,768 lekë (2015–2018) dhe 74,585,467 lekë (2019–2026). Këto shifra trajtohen si indikatorë ekspozimi financiar që e shtojnë rëndësinë e monitorimit të marrëdhënies ekonomike shtet–media. Këto të dhëna mund të jenë për efekt të reklamave shtetërore, transparenca e të cilave është detyrim në kuadër të integritetit siç e trajtuam më sipër.

Në plan më të gjerë, rrjeti ekonomik i lidhur me familjen Hoxha shfaqet si një portofol i shpërndarë në disa sektorë. Bërthama mbetet audiovizivi (Top Channel–DigitAlb dhe subjektet satelitë), por krahas tij vihet re shtrirje edhe në marketing/IT dhe reklamim, telekomunikacion, evente dhe industri kreative, import–eksport ushqimor, turizëm/transport, publikime dhe segmente të tjera shërbimesh, përfshirë edhe aktivitete që shtrihen drejt investimeve/ndërtimit në subjekte të caktuara. Në këtë arkitekturë, një rol “nyje” luan LORESA sh.p.k., entitet i kontrolluar nga Lorela Hoxha dhe Sara Hoxha (50%/50%), i ndërtuar mbi një transferim të mëparshëm kuotash nga Vjollca Hoxha (fillimisht 33.4% dhe më pas dhurim/kalim kuotash që çoi në ndarjen 50/50). Në të dhënat e mbledhura, LORESA evidentohet edhe si hallkë e rëndësishme në arkitekturën e pronësisë përreth DigitAlb (si aksioner me peshë), duke e bërë këtë shoqëri një pikë lidhëse mes pronësisë familjare dhe strukturës korporative të grupit audioviziv.

Paralelisht, familja Hoxha shfaq shtrirje aktiviteteve jashtë medias përmes subjekteve të specializuara. Në sektorin e import–eksportit ushqimor/verërave, shoqëria VINI & FOOD sh.p.k. rezulton me pjesëmarrje të anëtarëve të familjes Hoxha në 35% të kuotave, duke e vendosur portofolin edhe në një fushë tregtare “jo-media”, me natyrë importuese dhe zinxhir furnizimi. Në linjën e shërbimeve marketing/IT dhe reklamim, rezultojnë disa subjekte ku roli i Lorela Hoxhës është qendror (p.sh. aktiviteti si person fizik për shërbime marketingu, si edhe shoqëri të lidhura si Top News sh.p.k. për shërbime publicitare dhe IT). Për Top News, burimet publike tregojnë se shoqëria ka nisur me ortak themelues Vjollca Hoxha (100%), ndërsa më pas është reflektuar kalim i rolit të administrimit të Lorela Hoxha. Këto segmente janë të

rëndësishme për monitorim sepse lidhen drejtpërdrejt me tregun e komunikimit/reklamës, ku ekspozimi ndaj kontratave ose shpenzimeve publike mund të jetë indikator i fortë.

Përveç indikatorëve të ekspozimit financiar të evidentuar në transaksione thesari, rrjeti i lidhur me aktorët kryesorë audiovizivë rezulton të ketë përfituar edhe nga masa mbështetëse në kuadër të tranzicioneve teknologjike (p.sh. skema kompensuese me VKM) dhe nga instrumente të posaçme rregullatore si statusi “investitor strategjik” në projekte të caktuara. Këto mekanizma trajtohen më në detaje në kapitujt e mësipërm për politikën kompensuese dhe investimet strategjike, pasi përbëjnë forma të veçanta të ekspozimit ekonomik shtet-media me peshë të ndjeshme konkurruese.

Portofoli shtrihet edhe në telekomunikacion (ADTN sh.a. si shoqëri e lidhur me DigitAlb dhe me pronarë përfitues të raportuar), në industri kreative/kinema (Empire sh.p.k. e lidhur me DigitAlb), në publikime (SARAS sh.p.k. dhe njësi të tjera të lidhura me botim/online), si dhe në shërbime të tjera (sisteme elektronike/telekom, evente, transport/turizëm përmes subjekteve të kontrolluara nga Lorela Hoxha). Në tërësi, profili rezulton si një kombinim i bërthamës audiovizive; hallkave mbështetëse të komunikimit/IT dhe reklamimit; diversifikimeve tregtare në sektorë të tjerë, përfshirë edhe fusha ku lejet, licencat dhe vendimmarrja publike kanë peshë ekonomike, ku, së fundmi në turizëm dhe ndërtim.

Në termat e këtij raporti, ky profil nuk trajtohet si problem “në vetvete”, por si tipologji rrisht për monitorim, sa më i gjerë të jetë portofoli në sektorë ku vendimmarrja publike, licencat, lejet, kontratat publike apo rregullimi kanë peshë ekonomike, aq më e rëndësishme bëhet transparenca mbi ekspozimin financiar/rregullator dhe ndarja e qartë e interesave, për të shmangur perceptimet e varësisë ekonomike që mund të ndikojnë (drejtpërdrejt ose tërthorazi) mjedisin e konkurrencës dhe besimin publik.

Raportime mediatike mbi lidhje ekonomike të mundshme mes rrethit të Top Channel dhe aktorëve të përmendur në çështjen e inceneratorëve

Sipas raportimeve të publikuara në media, rrethi i pronësisë dhe drejtimin të Top Channel është përmendur në lidhje me disa marrëdhënie ekonomike që ndërthuren me aktorë të përfshirë në të ashtuquajturën “çështja e inceneratorëve”. Në këto raportime thuhet se, gjatë vitit 2019, Klodian Mërtiri ka zgjeruar ortakërinë e tij me persona të lidhur me drejtimin e Top Channel, përmes themelimit në Sofje, Bullgari, të shoqërisë “EM Capital Group AD”. Më tej, sipas të njëjtave burime mediatike, në nëntor 2019 kjo shoqëri ka blerë 51% të aksioneve të kompanisë “Valtelina” sh.p.k. - ish “Lori Caffè”, e lidhur me familjen Hoxha, për një vlerë të raportuar prej rreth 1.2 milionë eurosh.

Nëse këto të dhëna merren si të besueshme, ato krijojnë arsye për një analizë më të kujdesshme të marrëdhënies midis interesave ekonomike të lidhura me rrethin e medias dhe mënyrës së raportimit publik mbi çështjen e inceneratorëve. Kjo vlen veçanërisht në kontekstin kur, sipas vëzhgimeve publike, Top Channel ka pasur një qasje editoriale më të rezervuar ose më pak kritike ndaj koncesioneve të djegjes së mbetjeve, krahasuar me disa media të tjera që kanë publikuar vazhdimisht kritika, pretendime apo materiale investigative mbi këtë çështje. Në këtë këndvështrim, çështja nuk shtrihet si konstatim përfundimtar mbi ndikimin e interesave private në raportim, por si një element që meriton vëmendje në analizën e pluralizmit dhe pavarësisë editoriale. Raportimet mbi marrëdhënie të mundshme biznesi midis personave të lidhur me drejtimin e medias dhe aktorëve të përmendur në çështjen e inceneratorëve, të lexuara paralelisht me linjën editoriale të medias për këtë temë, mund të ngrejnjë pikëpyetje të arsyeshme mbi transparençën e interesave dhe mbi nevojën për deklaram më të qartë të lidhjeve që mund të perceptohen si konflikt interesi.



FAMILJA HOXHA

Rrjeti ekonomik i lidhur me familjen Hoxha



1. PËRDORIMI I ASETEVE ME ORIGJINË PUBLIKE



Rasti i PIRAMIDËS

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë

Përdorimi i pasurive publike në zona me vlerë të lartë urbane, si Piramida, mund të krijojë avantazh konkurrues nëse ofrohet me tarifa simbolike ose kushte preferenciale. Raporti rekomandon transparencë minimale të kontratave të përdorimit/qirasë, të aksesueshme publikisht: përfutuesi, afati, tarifa, baza ligjore dhe qëllimi i përdorimit.

2. INDIKATORË TË EKSPOZIMIT SHPET-MEDIA



DIGITALB

Familja Hoxha akcionere rreth 61% në DigitAlb.

Përfitime nga buxheti i shtetit:

2015-2018

8,108,349 lekë

2019-2026

12,037,600 lekë



TOP CHANNEL

Media kryesore audiovizive e lidhur me familjen Hoxha.

Transaksione në thesar:

2015-2018

50,115,768 lekë

2019-2026

74,585,467 lekë




TË TJERA SUBJEKTE TË LIDHURA

- Valtelina sh.p.k. (ortakë familjarë)
- Video Grafic Agency sh.p.k. (pjesëmarrje)
- Të tjera shoqëri në fushën e shërbimeve/komunikimit

3. ARKITEKTURA E PRONËSISË – NYJË KRYESORE LORESA sh.p.k.

TRANSFERIMI I KUOTAVE



ROLI NË GRUPIN AUDIOVIZIV

LORESA evidentohet si hallkë e rëndësishme në arkitekturën e pronësisë përreth DigitAlb, si akcioner me peshë, duke bërë këtë shoqëri një pikë lidhëse mes pronësisë familjare dhe strukturës korporative të grupit audioviziv.



LORESA sh.p.k. (akcioner me peshë)

4. PORTOFOLI I SHPËRNDARË NË SEKTORË TË NDRYSHËM



AUDIOVIZIV

- Top Channel – DigitAlb dhe subjektet satelitore
- Bërthama e grupit



MARKETING / IT DHE REKLAMIM

- Aktiviteti si person fizik i Lorela Hoxhës (marketing)
- Top News sh.p.k. (shërbime publicitare dhe IT)



TELEKOMUNIKACION

- ADTN sh.a. (e lidhur me DigitAlb)
- Pronarë përfutues të raportuar



INDUSTRI KREATIVE / KINEMA

- Empire sh.p.k. (e lidhur me DigitAlb)



PUBLIKIME

- SARAS sh.p.k.
- Subjekte të tjera me botim / online.



IMPORT – EKSPORT USHQIMOR / VERËRA

- VINI & FOOD sh.p.k. (pjesëmarrje e familjes Hoxha 35%)
- Aktivitet importues dhe zinxhir furnizimi



EVENTE DHE SHËRBIME

- Subjekte të lidhura në organizim eventesh dhe shërbime të ndryshme



TURIZËM / TRANSPORT

- Subjekte të kontrolluara nga Lorela Hoxha në transport, turizëm dhe mikpritje



SISTEME ELEKTRONIKE / TELEKOM

- Aktivitete në zgjidhje teknologjike dhe sisteme



INVESTIM / NDËRTIM

- Pjesëmarrje në subjekte me projekte të lidhura me ndërtim/zhvillim

5. STATUSI "INVESTITOR STRATEGJIK" – PROJEKTI ANIMA (TIRANË)



VENDIMI I KIS

Me Vendimin nr. 1, datë 10.04.2025, Këshilli i Investimeve Strategjike (KIS) miratoi statusin "Investitor strategjik – procedurë e veçantë" për projektin "ANIMA".



SUBJEKTE TË APLIKUJESË

- ANIMA CON sh.p.k. NUIS: M21803025R
- EB Construction sh.p.k. NUIS: L91619016G



PRONËSIA E ANIMA CON sh.p.k.

Ortakte: Lorela Hoxha (100%) Kuota e raportuar si e dhuruar nga Vjollca Hoxha.



PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Kompleks me funksion të përzirë: hotel / rezidencial / godina banimi dhe shërbimesh në Bashkinë Tiranë.



Vlera e investimit e raportuar: 55.6 milion euro



Sipërfaqja e projektit: rreth 0.96 ha (9,600 m²)

Çfarë përfshin statusi "Investitor strategjik" – procedurë e veçantë?

- Sipas ligjit nr. 55/2015 dhe VKM përkatëse, ky status ofron një regjim të posaçëm që mund të përfshijë:
- prioritet në shqyrtimin e procedurave dhe lejeve/autorizimeve
 - asistencë të dedikuar nga administrata publike ("one stop shop")
 - lehtësim në kushtet procedurale, brenda kornizës ligjore
 - monitorim të posaçëm nga KIS gjatë zbatimit të projektit



Rreziqet kryesore për monitorim

- Përfitim joproporcional krahasuar me projekte të tjera në treg
- Ndikim në konkurrencë
- Mundësi për trajtim preferencial në leje, kushte ndërtimi, afate
- Need për transparencë të plotë mbi të gjitha hapat dhe përfitimet

Ky projekt përbën një rast të rëndësishëm monitorimi për shkak të pronësisë së lidhur me rrethin e Top Channel dhe përfitimeve të mundshme rregulatore të statusit.

6. MASA MBËSHETËSE DHE INSTRUMENTE RREGULLATORE



Skema kompensuese me VKM (për tranzicionin teknologjik të televizionit dixhital).



Instrumente të posaçme rregullatore si statusi "investitor strategjik" në projekte të caktuara (p.sh. projekti ANIMA).



Forma të tjera mbështetjeje/ lehtësimi që mund të krijojnë avantazh ekonomik krahasues.

7. RAPORTIME MEDIATIKE – LIDHJET ME ÇËSHTJEN E INCENERATORËVE



Media ka raportuar lidhje ekonomike të mundshme mes rrethit të Top Channel dhe aktorëve të përfshirë në çështjen e inceneratorëve.



Pretendime që kërkojnë verifikim me dokumente primare: kontrata, pagesa, vendimmarrje publike dhe çdo transaksion përkatës.



Ky segment trajtohet si pistë verifikimi që kërkon transparencë dhe konfirmim nga burimet zyrtare.

3. VËLLEZËRIT DULAKU (MEDIA VIZION)

Tre vëllezërit Artan, Adrian dhe Genci Dulaku rezultojnë të lidhur me pronësinë/kontrollin e shoqërisë “MEDIA VIZION” sh.a. Grupi Dulaku ka një prani të konsoliduar në tregun mediatik përmes Vizion Plus, si media audiovizive kombëtare, dhe deri në dhjetor 2025 edhe përmes platformës Tring TV, si platformë transmetimi/pay-TV. Ndikimi i grupit zgjerohet më tej edhe përmes shoqërive të lidhura me rrjete dhe transmetim satelitor, si entitete të tipit “Albanian Satellite Communications”.

Vëllezërit Dulaku shfaqen si një grup i integruar, ku bërthama mediatike, e përbërë nga Vizion Plus/Media Vizion dhe Tring deri në fund të vitit 2025, shoqërohet me një portofol aktivitetesh në sektorë të rregulluar dhe me ndërveprim të lartë me autoritetet publike: turizëm/hospitality, zhvillim resortesh, infrastrukturë portuale/marina, telekom/rrjete transmetimi, siguri/menaxhim dhe shërbime mbështetëse. Në qendër të këtij rrjeti qëndron Concord Investment, si kompani qendrore ose “shoqëri mëmë”, me të paktën 9 shoqëri të lidhura drejtpërdrejt në listimin bazë të filialeve/entiteteve kyçe. Krahas kësaj bërthame, rrjeti zgjerohet edhe me shoqëri të tjera në administrim, IT/rrjete, shërbime dhe zhvillim, duke krijuar një portofol të qartë shumë-sektorial.

Përdorimi i aseteve me origjinë publike

Një tregues i parë i fortë janë përfitimet rregullatore/administrative të tipit “përdorim pasurie publike me tarifë simbolike”. Në profil identifikohen dy kontrata/qira “1 euro”, të miratuara me VKM dhe me afat 20-vjeçar, të lidhura me pasuri publike në Sarandë/Limion. E para lidhet me VKM nr. 226, datë 26.04.2018, për pasurinë “Pjesë të ambienteve të Portit të Limjonit”, me sipërfaqe të përgjithshme 5,370 m² (90 m² objekt dhe 5,280 m² sipërfaqe funksionale). E dyta lidhet me VKM nr. 514, datë 01.07.2020, për pasuri shtetërore në Gjirin e Limionit me sipërfaqe të përgjithshme 265,299 m². Vetë madhësia e sipërfaqeve dhe afati 20-vjeçar e vendosin këtë paketë si indikator të fortë “përdorim aset publik me peshë ekonomike”, që kërkon nivel të lartë dokumentimi dhe transparence. Portofoli përfshin dy statuse “investitor strategjik” për projekte turistike madhore (San Pietro dhe Gone Perivol), ndërsa për San Pietro evidentohen edhe parametra sasiorë: projekt resorti me sipërfaqe ndërtimi 140,000 m² në truall 334,827 m², me hoteleri 5 yje (500 dhoma) dhe fshat turistik/shërbime. Paralelisht, në profil shfaqet edhe një instrument tjetër tipik i ndërveprimit me shtetin: Partneritet Publik-Privat/koncesion për port turistik e shërbime (“Marina Limion”), i miratuar me VKM, ku një nga operatorët e përfshirë është EDILAL-IT.

Fusha e turizmit

Në këtë portofol hyn edhe grupi i projekteve në ndërtim dhe turizëm. Një shembull është projekti Arameras në Ksamil, ku Concord Investment rezulton ortak dominues dhe ku vetë përshkrimi e vendos kompleksin shumë pranë zonës së mbrojtur dhe Parkut të Butrintit, me shtrirje të deklaruar rreth 295,000 m².

Në të njëjtën linjë, në faqen e Concord Investment paraqitet edhe Marina of Orikum, një projekt që kombinon funksione turistike, rezidenciale dhe portuale. Projekti përshkruhet si marinë për jahte dhe mjete lundruese, e shoqëruar me apartamente, qendër tregtare, restorante, hapësira argëtimi, hoteleri, shtëpi pushimi, ambiente rekreative dhe park ujor. Ky projekt është i rëndësishëm për analizën, sepse ndodhet në kufirin midis zhvillimit turistik dhe infrastrukturës portuale, ku lejet, autorizimet dhe marrëdhëniet me asetet publike kanë ndikim të drejtpërdrejtë ekonomik.

Shembuj të tjerë janë Porto Karpen, Quiet Lake etj. Së bashku, këto projekte tregojnë natyrën shumë-sektoriale të portofolit të grupit Dulaku, ku media është vetëm një pjesë e ekosistemit ekonomik, ndërsa interesat kryesore shtrihen edhe në turizëm, hoteleri, marina, ndërtim dhe zhvillim rezidencial. Kjo e rrit nevojën për monitorim, pasi sa më i madh të jetë portofoli në sektorë që varen nga vendimmarrja administrative dhe rregullatore, aq më i lartë bëhet ekspozimi ndaj marrëdhënieve me shtetin dhe aq më e rëndësishme bëhet transparenca mbi përfitimet, statuset dhe kushtet lehtësuese.

Një bllok tjetër lidhet me koncesione/PPP në infrastrukturë turistike. Me VKM nr. 515, datë 01.07.2020, rezulton miratimi i kontratës koncesionare për portin turistik dhe shërbimet “Marina Limion”, ku përfshihet si operator një prej entiteteve të grupit, EDIL AL-IT. Ky është një indikator i qartë i ndërveprimit ekonomik me shtetin përmes instrumenteve afatgjata të partneritetit publik–privat.

Transaksione thesari

Në bërthamën mediatike, Media Vizion shfaq transaksione thesari: 16,307,950 lekë (2019–2026) dhe 21,141,750 lekë (2015–2018). Në të njëjtin ekosistem, një nyje shumë më e ekspozuar financiarisht është Albanian Satellite Communications (segment telekom/rrjete), me vlera të larta transaksionesh: rreth 471 milionë lekë për 2015–2018 dhe rreth 1.536 miliardë lekë për 2019–2026. Ky volum e bën këtë segment të rëndësishëm për monitorim, sepse telekomi/rrjetet janë fushë ku kontraktimi publik dhe marrëdhëniet me institucione janë të shpeshta.

Prokurime/kontrata në ndërtim dhe objekte publike (shembuj ilustrues)

Në profil shfaqen edhe disa kontrata me vlera të mëdha, të lidhura si me pushtetin vendor (veçanërisht Bashkia Tiranë) ashtu edhe me pushtetin qendror:

- prokurim për ndërtim rruge, Bashkia Tiranë, 85 milion lekë;
- bashkë-përfitim në “Godina nr. 22, blv. Zogu I”, Bashkia Tiranë, 144 milion lekë;
- prokurim “Parkimi Nëntokësor te Sheshi Italia”, Bashkia Tiranë, 337 milion lekë;
- prokurim “Rijetësimi i Piramidës Tiranë”, 1.25 miliardë lekë, me shtesë prej 228 milion lekë në vijim;
- tender nga Bashkia Gjirokastrë “Ndërtimi i godinës së parkimit dhe hapësirave mbështetëse në Gjirokastrë”, 290 milion lekë;
- prokurim “Rehabilitimin e Teatrit Kombëtar të Operas”, 100 milion lekë;
- përfitime në kuadër të Programit të Rindërtimit, “Rindërtimi i 14 objekteve arsimore në Bashkinë e Tiranës”, rreth 305 milion lekë.

Aktivitetet tregtare dhe kapacitetet prodhuese

Në të njëjtin ekosistem shfaqen edhe aktivitete ndërtimore/tregtare me ndikim, si ETC, Kristal Center dhe Concord Center. Materiali përmend gjithashtu se Alba-Beton deklaron zotërimin e pesë fabrikave betoni. Këto elemente e lidhin portofolin me sektorë ku lejet, standardet dhe kontraktimi publik/privat kanë peshë të drejtpërdrejtë. Ky profil përbën tipologji risku, sepse bashkon brenda të njëjtit grup media kombëtare, rrjete telekom/transmetimi, kontrata dhe përdorim pasurie publike, sipërfaqe të mëdha me afate të gjata, status “investitor strategjik”, PPP dhe projekte infrastrukturore/ndërtimore me vlera të konsiderueshme. Kjo rrit ekspozimin ekonomik ndaj vendimmarrjes publike dhe, për pasojë, nevojën për transparencë të standardizuar dhe gjurmueshmëri të përfitimeve, në funksion të konkurrencës së ndershme dhe besimit publik në pavarësi.



VËLLEZËRIT DULAKU

Rrjeti ekonomik i lidhur me familjen Dulaku



1. BËRTHAMA MEDIATIKE DHE PRONËSIA

Tre vëllezërit Artan, Adrian dhe Genci Dulaku rezultojnë të lidhur me pronësinë/kontrollin e shoqërisë "MEDIA VIZION" sh.a.



Artan DULAKU



Adrian DULAKU



Genci DULAKU



Media audiovizive kombëtare



Platformë transmetimi (pay-TV) deri në Dhjetor 2025



Rrjete/transmetim satelitor (p.sh. "Albanian Satellite Communications") që e zgjerojnë ndikimin e grupit

2. ARKITEKTURA E GRUPIT DHE PORTOFOLI I SHOQËRIVE

Concord Investment del si "shoqëri mëmë". Në listimin bazë të entiteteve kyçe evidentohen të paktën 9 shoqëri të lidhura direkt.



Rrjeti zgjerohet edhe me shoqëri të tjera në zinxhir (administrim, IT/rrjete, shërbime, zhvillim etj.).

3. PËRDORIMI I ASETEVE ME ORIGINJË PUBLIKE

Përfitimet rregulatore/administrative tip "1 euro", të miratuara me VKM dhe afat 20-vjeçar.



VKM nr. 226, datë 26.04.2018

Pasuria: "Pjesë të ambienteve të Portit të Limionit", Sarandë/Limion

- Sipërfaqe e përgjithshme: 5,370 m²
- 90 m² objekt
- 5,280 m² sipërfaqe funksionale



VKM nr. 514, datë 01.07.2020

Pasuri shtetërore në Gjirin e Limionit

- Sipërfaqe e përgjithshme: 265,299 m²



Madhësia e sipërfaqeve dhe afati 20-vjeçar e vendosin këtë paketë si indikator të fortë "përdorim aseti publik me pesë ekonomike". Kërkon dokumentim të plotë dhe transparencë.

4. PROJEKTE TURISTIKE, ZHVILLIMI DHE INFRASTRUKTURA PORTUALE

STATUS "INVESTITOR STRATEGJIK"



Projekti SAN PIETRO

- Projekt resorti
- Sipërfaqe ndërtimi: 140,000 m²
- Truall: 334,827 m²
- Hoteleri 5 yje (500 dhoma)
- Fshat turistik dhe shërbime



Projekti GONE PERIVOL

Status "Investitor strategjik"

PROJEKTE TURISTIKE DHE ZHVILLIM



ARAMERAS - KSAMIL

Kompleks turistik pranë zonës së mbrojtur dhe Parkut të Butrintit. Shtirje e deklaruar: rreth 295,000 m².



MARINA OF ORIKUM

Projekt që kombinon marinë për jahte, apartamente, qendër tregtare, restorant, ambiente argëtimi, hoteleri, shtëpi pushimi, ambiente rekreative, park ujor.



PORTO KARPEN, QUIET LAKE, etj.

Projekte të tjera turistike dhe rezidenciale.

KONCESIONE / PPP



Marina Limion

(Port turistik e shërbime)

VKM nr. 515, datë 01.07.2020
Miratimi i kontratës koncesionare (PPP) për dhënie me koncesion të portit turistik dhe shërbimeve "Marina Limion". Operator i përfshirë: EDIL AL-IT.

SEKTORË TË TJERË



Turizëm / Hospitality dhe resorte



Infrastrukturë portuale / marina



Telekom / rrjete transmetimi



Siguri / menaxhim



Shërbime mbështetëse për projektet



Portofoli është i shumë-sektorial: media + turizëm + ndërtim + marina + telekom + shërbime. Sa më i gjerë portofoli në sektorë të rregulluar, aq më i lartë ekspozimi ndaj vendimmarrjes publike dhe nevoja për transparencë mbi përfitimet e statuset e marra.

5. TRANSAKSIONE THESARI (EKSPOZIMI FINANCIAR)

MEDIA VIZION sh.a. (K01414003D)



2015-2018
21,141,750 lekë

2019-2026
16,307,950 lekë



ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS sh.p.k.

2015-2018
rreth 471 milionë lekë

2019-2026
rreth 1.536 miliardë lekë



Telekom/rrjete është segment me volum shumë të lartë transaksionesh dhe ndërveprim të shpeshtë me institucionet publike. Indikator i rëndësishëm për monitorim të kontraktimit publik dhe marrëdhënieve me shtetin.

6. PROKURIME / KONTRATA ME VLERA TË MËDHA (SHEMBUJ ILUSTRUES)



Ndërtim rruge, Bashkia Tiranë
Vlera: rreth 85 milion euro (pa TVSH)

Operator: EDIL AL-IT



Ndërtim kompleksi pallatesh, Bashkia Tiranë
Vlera: rreth 76 milion euro (pa TVSH)

Operator: EDIL AL-IT



GODINA e Degës së Thesarit, Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë
Vlera: rreth 8.2 milion euro (me TVSH)

Operator: EDIL AL-IT



Spital Riviera, Durrës
Vlera: rreth 12 milion euro (me TVSH)

Operator: EDIL AL-IT



Marina Porto Limion
Vlera e investimit: rreth 67 milion euro

Operator: EDIL AL-IT



Këto kontrata në ndërtim/objekte publike dhe infrastrukturë portuale përbëjnë tregues të fortë të ekspozimit ekonomik ndaj shtetit. Kërkojnë transparencë të plotë për vlerën, procedurën dhe ekzekutimin.

7. MASA DHE STATUS E TË VEÇANTA



STATUS "INVESTITOR STRATEGJIK" - PROJEKTE TURISTIKE MADHORE

Grupi Dulaku ka përfutur dy herë statusin "investitor strategjik" për projektet:

- San Pietro
- Gone Perivol

Ky status miratohet nga Këshilli i Investimeve Strategjike (KIS) dhe ofron procedurë të veçantë, përparësi në shqyrtimin e lejeve, asistencë nga administrata publike (one-stop shop) dhe lehtësime të tjera ligjore/regulatore. Kërkon publikim transparent të vendimeve të KIS, parametra të investimit, vendeve të punës dhe afateve.



PARTNERITET PUBLIK-PRIVAT / KONCESIONE

Përmes VKM nr. 515, datë 01.07.2020 miratohet kontrata koncesionare (PPP) për "Marina Limion" (port turistik e shërbime).

Koncesion afatgjatë me ndikim të drejtpërdrejt ekonomik përmes përdorimit të pasurive publike dhe shfrytëzimit të infrastrukturës portuale.



Rrjeti ekonomik i vëllezërve Dulaku paraqet një kombinim të bërthamës mediatike dhe një portofoli të gjerë në sektorë me ndikim të lartë rregullator. Nevoja për transparencë, ndarje të qartë interesi dhe monitorim të vazhdueshëm është thelbësore për mbrojtjen e konkurrencës së ndershme dhe besimit publik.

B. MEDIA LOKALE

Në kampionin e mediave lokale/rajonale, një numër i kufizuar rastesh shfaq një profil dukshëm më të gjerë interesash ekonomike krahasuar me pjesën tjetër. Këto raste trajtohen si nën-kampion për monitorim të thelluar, jo sepse përbëjnë shkelje në vetvete, por sepse paraqesin të njëjtën tipologji ekspozimi: diversifikim i lartë biznesesh të lidhura me pronësinë, prani në sektorë të rregulluar ku vendimmarrjet publike janë determinantë (p.sh. leje, autorizime, kontrata përdorimi, pasuri publike) dhe gjurmë të ndërveprimit financiar/rregullator me shtetin. Për këtë nën-kampion, monitorimi fokusohet në verifikimin e dokumenteve primare (akte, kontrata, leje) dhe në standardizimin e indikatorëve financiarë (transaksione thesari/prokurime), me qëllim rritjen e transparencës dhe kuptimin e ekspozimit ekonomik, pa nxjerrë përfundime mbi përmbajtjen editoriale.

1. Hysenbelliu/ Fokus Media Group

Përfitime nga asetet publike

Një kanal i qartë i ekspozimit ekonomik për grupin e lidhur me familjen Hysenbelliu lidhet me përdorimin me qira të pasurive publike, konkretisht ambientet ku operonte shoqëria Focus Media News sh.p.k. (News24/Radio News24/Balkanweb.com) në zonën e ish-Kombinatit të Autotraktorëve. Shoqëria ka lidhur kontratë qiraje me Ministrinë e Financave më 25.07.2002, me afat 20-vjeçar, pra përdorimi i pasurisë publike ka qenë i konsoliduar në kohë dhe afati përfundonte më 25.07.2022. Pas kësaj date, konflikti kalon në fazë “humbjeje të privilegjit”, pasi institucionet nisnin njoftime për lirimin/dorëzimin e sendit dhe, në periudhën 2022–2023, shfaqet një zinxhir veprimesh administrative për marrjen në dorëzim të pasurisë, duke përfshirë edhe paralajmërime për ndjekje të rrugës ligjore/përfshirje të strukturave të rendit në rast moslirimi. Për efekt të këtij raporti, rasti trajtohet si ilustrim i një mekanizmi ku një media mund të jetë përfitues “në kohë të gjatë” i një pasurie publike, ndërsa humbja e të drejtës për përdorim mund të ndodhë përmes masash administrative po aq të forta, duke krijuar hapësirë që dhënia dhe marrja e pasurisë publike të prodhojë presion praktik (ndërprerje funksionimi, rrezik teknikash, rrezik licencash) dhe, rrjedhimisht, të ndikojë perceptimin publik për trajtime preferenciale ose arbitraritet.

Prania mediatike dhe struktura e grupit

Irfan Hysenbelliu është një nga figurat më të konsoliduara të tregut mediatik shqiptar, me prani të rëndësishme në televizion, radio, shtypin e shkruar dhe median online, përmes Focus Media Group dhe Panorama Group. Në planin mediatik, ai kontrollon dy bërthama kryesore: Panorama Group, që përfshin gazetën Panorama, Panorama Sport, revistën Psikologjia dhe së fundmi Panorama TV; si dhe Focus Group, ku përfshihen Neës 24, Gazeta Shqiptare, BalkanWeb dhe radio Rash. Ky konfigurim e pozicionon atë si një aktor me ndikim të konsiderueshëm në formësimin e debatit publik, si në median tradicionale ashtu edhe në hapësirën online. Në qershor 2023, aksionet e Panorama Group iu kaluan dy fëmijëve të tij, çka tregon edhe një element të organizimit familjar të pronësisë mediatike.

Sa i takon të dhënave nga thesari, për Focus Group raportohen rreth 9 milion lekë të arkëtuara për periudhën 2015–2018 dhe 30 milion lekë për periudhën 2019–2026.

Marrëdhënia me pushtetin dhe lëvizja e pozicionimit editorial

Një element thelbësor i këtij profili është fakti se marrëdhënia e grupit Hysenbelliu me pushtetin nuk mund të lexohet në mënyrë statike. Gjatë dy dekadave si botues, ai raportohet të ketë mbajtur marrëdhënie të afërta si me figura të qeverisë, ashtu edhe me opozitën. Më vonë, sidomos pas konfliktit të hapur të lidhur me Prestige Resort, pas bllokimit dhe më pas prishjes së hotelit në pronësi të Hysenbelliut, raportohet se mediat e grupit të tij ndryshuan ndjeshëm qëndrimin editorial ndaj qeverisë. Ky episod ka rëndësi jo për të gjykuar vetë konfliktin, por për të evidentuar se kur një pronar mediaje ka interesa të rëndësishme ekonomike të ekspozuara ndaj shtetit, edhe linja editoriale e medias mund të lexohet në funksion të këtyre përplasjeve. Në këtë kuptim, rasti nuk duhet trajtuar si përjashtim, por si shembull i qartë i riskut që media të funksionojë si mjet negociimi, mbrojtjeje apo presioni në raport me pushtetin. Me fjalë të tjera, opozicioni editorial i sotëm nuk e zhbën ekspozimin e djeshëm ndaj pushtetit, as nuk e përjashton mundësinë që media të përdoret si instrument presioni në një konflikt që buron nga interesa ekonomike jashtë medias.

Konfliktet publike me shtetin dhe përdorimi i medias si levë presioni

Një element shtesë që e bën rastin Hysenbelliu veçanërisht të rëndësishëm për monitorim është numri i lartë i konflikteve publike dhe i akuzave të ndërsjella mes tij, mediave të grupit dhe institucioneve shtetërore. Materialet e publikuara tregojnë një model të përsëritur ku, nga njëra anë, aktorë shtetërorë ose pranë qeverisë e kanë akuzuar atë për përdorim të medias si mjet presioni në mbrojtje të interesave të biznesit, ndërsa nga ana tjetër vetë Hysenbelliu dhe mediat e tij e kanë paraqitur veten si objekt të hakmarrjes politike, presionit administrativ ose cenimit të lirisë së medias. Kjo skemë është shfaqur në forma të ndryshme: p.sh., në konfliktin me Doganat, ku drejtori i përgjithshëm e akuzoi publikisht Hysenbelliun për shantazh pas një gjobe të vendosur ndaj biznesit të tij, ndërsa News24 dhe BalkanWeb e paraqitën reagimin e institucioneve si përpjekje për të shmangur përgjigjen ndaj fakteve të publikuara; në episodin e Prestige Resort, ku prishja e objektit u interpretua nga grupi mediatik si sulm i lidhur me linjën editoriale të mediave të tij; si edhe në debatet më të hershme rreth Universitetit Luarasi, ku konfliktet mbi përdorimin e pasurive publike u shoqëruan me fushata të forta mediatike dhe kundërrakuza publike. Po kështu, në materiale të tjera mediatike janë ngritur pretendime për borxhe të larta tatimore, për trajtim preferencial ose për tolerim institucional ndaj bizneseve të tij, ndërkohë që nga ana tjetër grupi i Hysenbelliut i ka paraqitur vetveten si objekt të goditjeve të qëllimshme shtetërore. Për qëllimet e këtij raporti, rëndësia e këtyre episodeve nuk qëndron te marrja si të mirëqena e pretendimeve të njëjës ose tjetrës palë, por te fakti se ato tregojnë një ndërthurje të vazhdueshme mes konfliktit ekonomik, konfliktit me shtetin dhe pozicionimit editorial të medias. Pikërisht kjo e bën të nevojshëm monitorimin e rasteve kur media përdoret, ose perceptohet se përdoret, si instrument negociimi, mbrojtjeje apo presioni në funksion të interesave jashtë vetë fushës mediatike.

Portofoli ekonomik jashtë medias

Paralelisht me aktivitetin mediatik, Hysenbelliu ka ndërtuar një portofol të gjerë ekonomik në fusha si ndërtimi, hoteleria, prodhimi i birrës, arsimiti i lartë privat, telekomunikacioni, transporti dhe shërbime të tjera tregtare. Në materialin e mbledhur rezultojnë rreth 30 shoqëri ku ai ka pronësi ose kontroll, të shpërndara në sektorë me ekspozim të lartë rregullator dhe ekonomik. Në to përfshihen universitete private, kompani ndërtimi, shoqëri hotelerie e turizmi, tregtim pijesh alkoolike, telekomunikacion, sisteme elektronike, transport,

import–eksport dhe kompani të tjera mbështetëse. Bërthama mediatike ndërthuret kështu me një arkitekturë të gjerë biznesi ku lejet, licencat, kontratat publike, politika fiskale dhe vendimmarrja administrative kanë peshë të drejtpërdrejtë ekonomike.

Ekspozimi ndaj fondeve publike

Edhe të dhënat e transaksioneve në thesar e shtojnë rëndësinë e monitorimit të këtij profili. Jo vetëm shoqëritë mediatike të lidhura me grupin kanë përfituar fonde publike në periudha të ndryshme. Përveç bërthamës mediatike, në material figurojnë edhe përfitime të tjera nga thesari për subjekte jashtë medias, në vlera mbi 100 million lekë, të akorduara për si Universitetin Luarasi, shoqëria HYSENBELLIU apo MELITA, çka tregon se ekspozimi financiar ndaj shtetit, shtrihet në pjesë të tjera të portofolit.

Sektorët me risk të lartë rregullator

Një pjesë veçanërisht domethënëse e profilit të tij lidhet me ndërtimin dhe hotelerinë. Nga të dhënat e mbledhura përmenden disa subjekte ndërtimi dhe projekte konkrete, përfshirë ndërtime në Tiranë, Golem dhe Elbasan, si edhe shoqëri të tjera të përfshira në veprimtari ndërtimi, projektimi dhe zhvillimi. Përveç kësaj, përfshirja në hoteleri, turizëm dhe resorte e bën këtë profil edhe më të varur nga vendimmarrja administrative, lejet e zhvillimit, politikat territoriale dhe raportet me pushtetin vendor e qendror. Mbi 10 leje ndërtimi për Rezidenca dhe resorte në Tiranë, Kavajë, Elbasan ekspozohen në faqen e vetë shoqërisë “Erjoni” shpk. Këtu qëndron edhe arsyeja pse konflikti i Prestige Resort nuk duhet lexuar si episod i izoluar. Ai është shfaqja më e dukshme e një risku strukturor që buron nga vetë ndërthurja e medias me aktivitete ekonomike të ndjeshme ndaj shtetit. Rasti i Universitetit Luarasi e plotëson më tej këtë tablo, sepse tregon ndërthurjen e aktivitetit privat me përdorimin e pasurive publike dhe vendimmarrjen qeveritare. Sipas informacionit të mbledhur, çështja e akomodimit të universitetit në godinën e konvikteve të gjuhëve të huaja, në gusht 2013 është shoqëruar me debat publik dhe akuza për favorizim politik. Pavarësisht evolucionit të mëvonshëm të situatës, vetë ekzistenca e një marrëdhënieje të tillë me pasuri publike e forcon argumentin se ky nuk është thjesht një profil mediatik, por një profil ku media bashkëjeton me interesa ekonomike të ekspozuar ndaj favorizimit, ndërhyrjes apo konfliktit me pushtetin.

Në terma të këtij raporti, profili i Irfan Hysenbelliut nuk duhet trajtuar si problem “në vetvete” për shkak të faktit se ai ka shumë aktivitete ekonomike, apo sepse sot mban një qëndrim editorial kritik ndaj qeverisë. Çështja është tjetër: fakti që media e tij është pjesë e një portofoli të gjerë biznesesh me ekspozim të ndjeshëm ndaj shtetit e bën të nevojshëm monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies mes interesave ekonomike, fondeve publike, vendimmarrjes administrative dhe linjës editoriale. Në një treg mediatik të vogël, ku kufiri mes konfliktit ekonomik dhe konfliktit editorial mund të bëhet lehtësisht i paqartë, rasti Hysenbelliu është shembull i qartë se pluralizmi nuk matet vetëm nga numri i mediave, por edhe nga shkalla në të cilën ato janë të lira nga ndërthurja me interesa të tjerë ekonomikë dhe nga nevoja për të përdorur ndikimin mediatik si levë në raport me pushtetin.



HYSENBELLIU / FOKUS MEDIA GROUP

Profili i ekspozimit ekonomik, marrëdhënieve me shtetin dhe rreziqeve për pavarësinë editoriale

news 24

RADIO NEWS 24

BalkanWeb.com

1. PËRDORIMI I ASETIT PUBLIK – ISH KOMBINATI I AUTOTRAKTORËVE



Shoqëria Focus Media News sh.p.k. (News24 / Radio News24 / Balkanweb.com) ka përdorur ambiente shtetërore në zonën e ish-Kombinatit të Autotaktorëve.



KONTRATË QIRAJE

Lidhur me Ministrinë e Financave më 25.07.2002



AFATI

20-vjeçar (deri më 25.07.2022)



PAS PËRFUNDIMIT TË AFATIT

2022–2023: njoftime për lirim / dorëzimin e sendit, paralajmërim për ndjekje ligjore dhe përfshirje të strukturave të rendit në rast moslirimi.



Rasti ilustron mekanizmin ku një media mund të përfitojë në kohë të gjatë nga një pasuri publike dhe humbja e këtij privilegj mund të prodhohet presion praktik (ndërprerje funksionimi, rrezik teknikatsh, rrezik licencash), duke ndikuar perceptimin publik për trajtime preferenciale ose arbitraritet.

2. PRANIA MEDIATIKE DHE STRUKTURA E GRUPIT

Irfan Hysenbelliu kontrollon dy bërthama kryesore mediatike:



PANORAMA GROUP

- Gazeta Panorama
- Panorama Sport
- Revista Psikologjia
- Panorama TV (së fundmi)



FOCUS FOCUS MEDIA GROUP

- News24 (TV)
- Gazeta Shqiptare
- BalkanWeb.com
- Radio Rash (Radio News24)



Në qershor 2023, aksionet e Panorama Group iu kaluan dy fëmijëve të tij, çka tregon element të organizimit familjar të pronësisë mediatike.

TRANSAKSIONE THESARI (FOCUS GROUP)



2015–2018 rreth 9 milion lekë

2019–2026 rreth 30 milion lekë

3. MARRËDHËNIA ME PUSHTETIN DHE POZICIONIMI EDITORIAL



Gjatë dy dekadave si botues, raportohet të ketë mbajtur marrëdhënie të afërta si me figura të qeverisë, ashtu edhe me opozitën.



Pas konfliktit të hapur lidhur me Prestige Resort (bllokimi dhe prishja e hotelit në pronësi të tij), mediat e grupit ndryshuan ndjeshëm qëndrimin editorial ndaj qeverisë.



Kur një pronar mediaje ka interesa ekonomike të ekspozuara ndaj shtetit, linja editoriale e medias mund të lexohet në funksion të këtyre përplasjeve. Opozicioni editorial i sotëm nuk e zhbën ekspozimin e djeshëm ndaj pushtetit.

4. KONFLIKTET PUBLIKE ME SHTETIN DHE PËRDORIMI I MEDIAS SI LEVË PRESIONI



Konflikti me Doganat

Drejtori i përgjithshëm e akuzoi publikisht Hysenbelliu për shantazh pas një gjobe ndaj biznesit të tij, News24 dhe BalkanWeb e paraqitën reagimin e institucioneve si përpjekje për të shmangur faktet.



Prestige Resort

Prishja e objektit u interpretua nga grupi mediatik si sulm i lidhur me linjën editoriale.



Universiteti Luarasi

Konfliktet mbi përdorimin e pasurive publike u shoqëruan me fushata të forta mediatike dhe kundërshtime publike.



Akuzat e ndërsjella

Pretendime për borxhe tatimore, trajtim preferencial ose tolerim institucional ndaj bizneseve: nga ana tjetër, grupi paraqitet si objekt i goditjeve të qëllimshme shtetërore.



Këto episode tregojnë ndërthurjen e vazhdueshme mes konfliktit ekonomik, konfliktit me shtetin dhe pozicionimit editorial të medias.

Media mund të përdoret, ose perceptohet se përdoret, si instrument negociimi, mbrojtjeje apo presioni në funksion të interesave jashtë fushës mediatike.

5. PORTOFOLI EKONOMIK JASHTË MEDIAS



Ndërtim & zhvillim imobiliar



Hoteleri & turizëm



Tregti & import-eksport



Investime & shoqëri të tjera



Këto interesa e rrisin ekspozimin ndaj vendimmarrjes publike (leje, kontrata, taksa, inspektime) dhe mund të ndikojnë mjedisin editorial përmes presionit ekonomik.

6. PROKURIME / KONTRATA ME VLERA TË MËDHA (SHEMBUJ ILUSTRUES)

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT / KONTRATËS	AKTORI PUBLIK	OPERATORI	VLERA
Ndërtim rruge	Bashkia Tiranë	Shjak 2002	rreth 85 milion € (pa TVSH)
Ndërtim kompleksi pallatesh	Bashkia Tiranë	Shjak 2002	rreth 76 milion € (pa TVSH)
Godina e Degës së Thesarit, Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"	Qeveria (Thesari)	ED KONSTRUKSION	rreth 8.2 milion € (me TVSH)

7. INDIKATORËT E RREZIKUT KRYESOR



Përdorimi i gjatë i asetit publik me kushte preferenciale (dhe konflikti pas humbjes së afatit).



Portofol i gjerë jashtë medias në sektorë me intensitet të lartë vendimmarrjeje publike (ndërtim, turizëm, taksa, inspektime).



Konflikte të përsëritura me institucione shtetërore dhe akuzat e ndërsjella për përdorim të medias si levë presioni.



Ekspozimi financiar publik (transaksione thesari) për bërthamën mediatike.



Rrezik për pavarësinë editoriale dhe perceptimin publik për trajtime preferenciale.

8. REKOMANDIME PËR MINIMIZIMIN E RREZIQEVE



Transparenca e plotë për kontratat e përdorimit të pasurisë publike (afati, tarifa, baza ligjore, destinacion).



Ndarje e qartë institucionale dhe financiare midis aktivitetit mediatik dhe bizneseve të tjera.



Transparenca e rregullt për transaksionet me thesarin dhe kontratat publike të fituara.



Mekanizma të brendshëm për mbrojtjen e pavarësisë editoriale dhe menaxhimin e konflikteve të interesit.



Monitorim i vazhdueshëm nga autoritetet dhe shoqëria civile.



Rasti Hysenbelliu ilustron një tipologji rrisi ku media, asetet publike dhe interesat ekonomike jashtë medias ndërthuren në mënyrë komplekse. Transparenca, dokumentimi dhe ndarja e qartë e interesave janë thelbësore për të mbrojtur pavarësinë editoriale, konkurrencën e ndershme dhe besimin publik.

2. Vëllëzërit Ulaj / A2

Grupi i vëllëzërve Ulaj paraqitet si një ekosistem i integruar, ku media A2/G2 Media është vetëm një degë brenda një portofoli shumë më të gjerë, të përqendruar në sektorë me varësi të lartë nga vendimmarrja publike: ndërtim, infrastrukturë, PPP/koncesione, energji dhe teknologji/telekom. Struktura organizohet rreth dy nyjeve kryesore, ABA HOLDING/NDD dhe bërthamës operacionale GENER 2, me një rrjet të gjerë shoqërisht të kontrolluara. Në hartën e grupit evidentohen të paktën 31 shoqëri, tipike për një model që operon me projekte të mëdha përmes SPV-ve, ku ndahen risqet, konsolidohen kontratat dhe kanalizohet financimi e zbatimi.

Në segmentin mediatik, Televizioni A2 operon përmes G2 Media sh.p.k. Për periudhën 2019–2026, G2 Media rezulton përfitues nga thesari me rreth 9.8 milionë lekë. Kjo shifër relativisht e ulët tregon se ekspozimi ekonomik kryesor i grupit nuk lidhet me degën mediatike, por me sektorë të tjerë me peshë të madhe, si infrastruktura, energjia dhe PPP-të.

Partneritet Publik Privat (PPP)/koncesione në infrastrukturë, rrugë kombëtare dhe projekte urbane

Pesha ekonomike e grupit shfaqet qartë në portofolin PPP/koncesionar, ku identifikohen tre blloqe infrastrukturë të rëndësishme:

- Segmentin rrugor Milot–Thumanë, me shoqëri të dedikuar koncesionare;
- Aksi Thumanë–Fushë-Krujë–Vorë–Kashar;
- Projekti urban Parkimi Nëntokësor i Sheshit “Italia” në Tiranë (BOT), i strukturuar përmes shoqërisë së dedikuar të projektit.

Këto kontrata janë tipikisht me ekspozim të lartë, për analizën e këtij raporti, pasi krijojnë marrëdhënie afatgjata me shtetin dhe kërkojnë standard të lartë transparence mbi kushtet kontraktore, ndryshimet, dhe impaktin konkurrues.

Partneritete publike të kontestuara dhe prokurime me vlera të larta

Përveç PPP-ve kryesore, profili përfshin edhe raste partneriteti publik të raportuara me “flamur të kuq” nga monitorues të prokurimeve, si dhe prokurime infrastrukturore me fonde të larta. Shembuj janë dhënia në përdorim për studim për një park energjetik eolik në Bashkinë Dropull; prokurimi për furnizimin me ujë të fshatrave Vertop, Bregas, Fushë-Peshtan dhe Vodice në Bashkinë Poliçan, me fond limit 700,000,000 lekë; si edhe ndërtimi i KUZ dhe rrjetit terciar për UK Vlorë, me fond limit 274,779,449 lekë.

Në këtë model raportimi, këto raste shërbejnë si indikatorë të ekspozimit sasior, pasi tregojnë ndërveprim të rëndësishëm me vendimmarrjen dhe fondet publike në sektorë të rregulluar.

Ndërtim dhe zhvillim urban me intensitet projektësh dhe lelesh

Në portofolin e projekteve ndërtimore evidentohen 25 adresa/projekte, nga të cilat 7 janë banim dhe/ose shërbime polifunkionale, me përqendrim të dukshëm në Tiranë. Ky intensitet është relevant, sepse zhvillimi urban dhe ndërtimi varen drejtpërdrejt nga leje, kushte, ndryshime projekti dhe vendimmarrje administrative.

Profili përfshin edhe një projekt të kontestuar publikisht në hoteleri/turizëm: lejen e KKT-së për resortin “Blue Borgo” në Rrjoll, Shkodër, me 37 struktura akomoduese nga 3 deri në 10 kate, shoqëruar me protesta dhe debat publik.

Procesi i rindërtimit

Në këtë profil përfshihet edhe Procesi i Rindërtimit, ku grupi shfaqet i pranishëm në projekte publike të sektorit arsimor. Konkretisht, evidentohet pjesëmarrja në kuadër të “Rindërtimit të 14 (katërbëdhjetë) objekteve arsimore në Bashkinë e Tiranës”, si pjesë e Programit të Rindërtimit, përmes një marrëveshjeje kuadër dhe mini-konkursi.

Pjesëmarrje në kuadër të Programit të Rindërtimit trajtohet si tregues i ekspozimit ekonomik përmes kontraktimit publik në një program të posaçëm shtetëror, ku përfitimi shfaqet në formën e aksesit në projekte të financuara nga fondet publike dhe të ndjekura me prioritet institucional. Njëkohësisht, ky element vendoset në një kontekst më të gjerë, pasi Programi i Rindërtimit ka qenë objekt debatesh dhe shqetësimesh publike lidhur me menaxhimin dhe transparencën e fondeve, si dhe standardet e prokurimit dhe zbatimit. Për këtë arsye, në këtë raport nuk merret si konkluzion ndaj një subjekti të caktuar, por si arsye shtesë pse kontraktimet në kuadër të rindërtimit duhen trajtuar me standard më të lartë transparence dhe gjurmueshmërie.

Portofol energjetik me shoqëri projekti (SPV), koncesione dhe impiant energjistik

Në energji, profili paraqitet si portofol i strukturuar me shoqëri Subjekt i Posaçëm (SPV) dhe projekte të lidhura me koncesione hidroenergjetike (BOT) dhe zhvillime të tjera energjetike. Përfshihen këtu shoqëri e dedikuar për HEC “Suha” (me proces konkurrues dhe parametra teknike), hidrocentralet mbi Zallin e Qarrishtës (BOT), dhe HEC “Dragobia” (me tregues të lartë transaksionesh thesari në periudhën 2019–2026).

Për më tepër, evidentohet se në fillim të vitit 2025 KKTU ka miratuar leje ndërtimi për një impiant energjistik me cikël të kombinuar, 1–2 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë) në Bashkinë Roskovec, ku përfituesit përfshijnë edhe vëllezërit Ulaj.

Edhe ky është një sektor tipik me ekspozim të lartë sepse integrimi në sistem, lejet dhe kushtet koncesionare janë tërësisht të varura nga vendimmarrja publike dhe rregullimi sektorial.

Tregues përmbledhës i ekspozimit financiar të grupit dhe aktivitete të tjera

Në profil evidentohet edhe një tregues i fortë i ekspozimit financiar, ku për periudhën 2019–2026, përfitimi i pasqyruar nga thesari për grupin (në nivel shoqërisht të lidhura) arrin 8,497,519,427 lekë.

Në hartën e grupit shfaqen shoqëri të lidhura me datacom/datacenter/telekom dhe sisteme teknologjike, si dhe entitete shërbimesh teknologjike. Kjo degë është relevante për monitorim sepse telekomunikacioni dhe infrastruktura digjitale janë fusha ku licencimi/autorizimet dhe marrëdhëniet kontraktore me institucione publike kanë peshë ekonomike të konsiderueshme.

Arsyeja pse grupi trajtohet si rast studimi është për të kuptuar mekanizmat që mund të krijojnë ekspozim të lartë dhe potencialisht avantazh konkurrues, duke ndikuar edhe në perceptimin e pavarësisë së medias. Ndaj ky profil nuk trajtohet si “problem” në vetvete dhe nuk synon inventarizim pasurish. Ai përdoret si tipologji rrisht, kur një grup që kontrollon edhe media ka paralelisht një portofol të gjerë në ndërtim/infrastrukturë, PPP/koncesione, energji dhe teknologji/telekom, pra në sektorë ku vendimmarrja publike është pjesë e mekanizmit ekonomik, rritet rëndësia e transparencës dhe e standardizimit të informacionit.



VËLLËZËRIT ULAJ / A2

Ekosistemi ekonomik i grupit dhe indikatorët e ekspozimit shtet-media

PROFILI I GRUPIT



Media (A2/G2 Media) është vetëm një degë brenda një portofoli të gjerë në sektorë me varësi të lartë nga vendimmarrja publike: ndërtim, infrastrukturë, PPP/koncesione, energji, teknologji/telekom etj.

Në hartën e grupit evidentohen të paktën 31 shoqëri të kontrolluara.

NYJET Kryesore



SEGMENTI MEDIATIK



Televizioni A2 operon përmes shoqërisë G2 Media sh.p.k.

Për periudhën 2019–2026, G2 Media rezulton përfutues nga thesari me rreth **9.8 milionë lekë.**

1. PPP / KONCESIONE NË INFRASTRUKTURË DHE PROJEKTE URBANE



PPP Milot – Thumanë

Segment rrugor në partneritet publik-privat përmes shoqërisë koncesionare të dedikuar.



PPP Thumanë – Fushë-Krujë – Vorë – Kashar

Aks rrugor i rëndësishëm kombëtar në partneritet publik-privat.



Parkimi Nëntokësor i Sheshit "Italia", Tiranë (BOT)

Projekt urban i strukturuar përmes shoqërisë së dedikuar të projektit.



Kontrata me ekspozim të lartë afatgjatë me shtetin. Kërkohej transparencë mbi kushtet kontraktore, dryshimet dhe impaktin konkurrues.

2. PARTNERITETE PUBLIKE TË KONTESTUARA DHE PROKURIME ME VLERA TË LARTA



Dhënie në përdorim për studim në funksion të ndërtimit të një parku energjetik eolik në Bashkinë Dropull.



Prokurimi: "Furnizimi me ujë i fshatrave Vertop, Bregas, Fushë-Peshtan dhe Vodicë, Bashkia Poliçan"
Fond limit: 700,000,000 lekë.



Prokurim: Ndërtim KUZ dhe rrjet terciar për UK Vlorë
Fond limit: 274,779,449 lekë.



Raste me "flamur të kuq" dhe prokurime infrastrukturore me fonde të larta, indikator të ekspozimit ndaj vendimmarrjes publike dhe fondeve publike.

3. NDËRTIM DHE ZHVILLIM URBAN



25 adresa / projekte ndërtimi, nga të cilat 7 të natyrës banim dhe/ose shërbime (polifunkionale), me përqendrim në Tiranë.



Projekti i kontestuar publikisht: Resorti turistik "Blue Borgo" në Rrjoll (Shkodër)
37 struktura akomoduese nga 3 deri në 10 kate, i shoqëruar me protesta dhe debat publik.



Sektor me varësi të lartë nga leje, kushte, ndryshime projekti dhe vendimmarrje administrative.

4. PROCESI I RINDËRTIMIT



Pjesëmarrje në "Rindërtimin e 14 (katërbëdhjetë) objekteve arsimore në Bashkinë e Tiranës" në kuadër të Programit të Rindërtimit, përmes marrëveshjes kuadër dhe mini-konkursit.



Tregues i ekspozimit ekonomik përmes kontraktimit publik në program të posaçëm shtetëror. Programi i Rindërtimit ka qenë objekt debatesh publike lidhur me menaxhimin dhe transparencën e fondeve; prandaj kërkohej standard i lartë transparence dhe gjurmueshmërie.

5. PORTOFOLI ENERGETIK



- SPV për HEC "Suha" – proces konkurrues, parametra teknike të projektit.
- Hidrocentralet mbi Zallin e Qarrishtës (BOT).
- HEC "Dragobia" – transaksione të larta thesari 2019–2026.
- Leje ndërtimi për impiant energjiek me cikël të kombinuar (1–2 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë) në Bashkinë Roskovec (miratuar nga KKTU në fillim të vitit 2025), ku përfutuesit përfshijnë edhe vëllëzërit Ulaj.



Sektor me ekspozim të lartë: lejet, integrimi në sistem, kushtet koncesionare dhe rregullimi sektorial varen tërësisht nga vendimmarrja publike.

6. TREGUES PËRMBLEDHËS I EKSPOZIMIT FINANCIAR TË GRUPIT



Për periudhën 2019–2026, përfitimi i pasqyruar nga thesari për grupin (në nivel shoqërisht të lidhura) arrin:

8,497,519,427 lekë

AKTIVITETE TË TJERA NË PORTOFOL

- ✓ Datacom / datacenter / telekom dhe sisteme teknologjike.
- ✓ Tregti, logjistikë, shërbime mbështetëse dhe mirëmbajtje.
- ✓ Shoqëri të dedikuara për menaxhim dhe zhvillim projektesh.



7. INDIKATORËT Kryesore të Riskut



Ekspozim i lartë ndaj vendimmarrjes publike (leje, koncesione, PPP, prokurime, kontrata publike).



Portofol i gjerë në sektorë të rregulluar me intensitet të lartë hyrje-dalje administrative.



Numër i lartë shoqërisht (SPV) që mund të përdoren për ndarje risqesh, konsolidim kontratash dhe zbatim projektesh.



Kontrata afatgjata PPP/koncesionare me impakt buxhetor dhe konkurrues.



Nevojë e lartë për transparencë mbi përfitimet, ndryshimet e kontratave dhe lidhjet ndërmjet subjekteve.



Publikim i plotë i kontratave PPP/koncesionare dhe i akteve shtesë.



Transparencë mbi lejet, miratimet dhe ndryshimet e projekteve.



Publikim i lidhjeve ndërmjet shoqërive të grupit dhe përfitimeve të marra nga fonde publike.



Monitorim i vazhdueshëm i prokurimeve publike dhe i ekspozimit financiar të grupit në të gjitha sektorët.



Vlerësim i rregullt i ndikimit ekonomik dhe konkurrues të kontratave dhe projekteve të grupit.



Rasti i vëllëzërit Ulaj trajtohet si tipologji risku për monitorim: sa më i gjerë të jetë portofoli në sektorë që varen nga vendimmarrja publike, aq më e lartë është ekspozimi ndaj marrëdhënieve me shtetin dhe aq më e rëndësishme bëhet transparencja.

3. Report TV (MTSC sh.p.k.)/Carlo Bollino

Report TV operon përmes shoqërisë “MTSC” sh.p.k., e cila ka si objekt kryesor aktivitetin në fushën e transmetimeve radio-televizive. Në të dhënat e hapura të regjistrimit, MTSC paraqitet si pjesë e një strukture të kontrolluar nga Carlo Bollino.

Sa i përket ekspozimit financiar, të dhënat e transaksioneve të thesarit për periudhën 2019–2026 tregojnë se përfituesi “MTSC” rezulton me një vlerë totale 79,763,672 lekë, të regjistruara në 5 transaksione, sipas shërbimit “Open Spending Albania”, i cili bazohet në sistemin e shpenzimeve të Zyrës Qendrore të Thesarit.

Përdorimi i aseteve me origjinë publike

Një komponent qendror i profilit ekonomik të këtij grupi lidhet me përfitimin e aseteve publike me cmime simbolike të njohur si “qira me tarifën 1 euro/kontrata”. Me VKM nr. 642, datë 02.10.2019, Këshilli i Ministrave miraton lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (qiradhënës) dhe shoqërisë MTSC sh.p.k. (qiramarrës), për pasurinë shtetërore “ish-Ndërmarrje Metalike ‘Tirana’ (Reparti i orëve)”, në përgjegjësi administrimi të Ndërmarrjes Industriale nr. 1, Tiranë. Vendimi specifikon sipërfaqen e pronës së dhënë me qira: 4021 m² sipërfaqe e përgjithshme, me 1624 m² sipërfaqe ndërtimore dhe 2397 m² sipërfaqe funksionale, si edhe afatin 20 vjet. Qëllimi i përdorimit, sipas projektkontratës, lidhet me rikonstruksionin e godinës dhe përshtatjen e saj me parametrat teknikë të një televizioni bashkëkohor, si edhe ngritjen e një qendre mediatike transmetimi.

Në këtë kontekst, vlen të evidentohet se më herët, në Buletinin nr. 29, datë 22.07.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik, është njoftuar procedura për dhënien me qira të kësaj pasurie me vlerë dysheme 631,156 lekë/muaj. Në raport, kjo mbetet një pistë e rëndësishme monitorimi sepse nuk rezulton e qartë në burimet e disponueshme se si u arrit kalimi nga ky nivel i njoftuar i qirasë në regjimin e miratuar më pas me tarifë 1 euro, dhe cilat elemente e arsyetuan këtë ndryshim.

Pas vendimit bazë, ky regjim pasurie shtetërore është pasuar me akte shtesë. Me VKM nr. 157, datë 19.02.2020, miratohet një shtesë në kontratën e qirasë së miratuar me VKM nr. 642/2019, konkretisht për një sipërfaqe 872 m² në godinën nr. 1, kati i dytë (brenda pronës së dhënë me qira). Në vijimësi, me VKM nr. 368, datë 06.05.2020, autorizohet shembja e tre objekteve (një 2-katësh dhe dy 1-katëshe), të lidhura me kontratën e qirasë 1 euro. Në vetë këtë vendimmarrje, arsyetimi për kalimin nga logjika e “rikonstruksionit” drejt shembjes nuk shpaloset në mënyrë të detajuar, çka e bën edhe këtë aspekt pjesë të monitorimit të transparencës së vendimmarrjes.

Këto akte janë të rëndësishme për raportin jo si “gjykim” mbi ligjshmërinë e tyre (gjë që kërkon analizë të veçantë), por si indikator i një ekspozimi rregullator me peshë ekonomike. Një media private përfiton një pasuri shtetërore me sipërfaqe disa mijëra m², në një zonë qendrore të kryeqytetit, me tarifë simbolike 1 euro, e shoqëruar nga një seri vendimesh që e modifikojnë dhe e operacionalizojnë kontratën (shtesa, ndryshime kontraktuale dhe ndërhyrje strukturore në kompleks).

Bunk'Art, fondet publike dhe mungesa e transparencës

Rasti i Carlo Bollino-s ngre pikëpyetje jo vetëm për lidhjet mes pronësisë mediatike dhe përfitimeve publike, por edhe për mënyrën se si pasuritë publike dhe fondet shtetërore mund të përdoren në mungesë të standardeve të plota të transparencës. Në debatin publik janë ngritur pretendime se Bollino ose subjekte të lidhura me të kanë përfituar nga përdorimi i aseteve publike dhe nga kontrata të ndryshme me institucione shtetërore, përfshirë edhe rastet e Bunk'Art 1 dhe Bunk'Art 2, të cilat janë paraqitur si shembuj të dhënies në përdorim të objekteve publike pa një transparencë të mjaftueshme mbi procedurën, kushtet kontraktore dhe përfitimet ekonomike që burojnë prej tyre.

Edhe pa hyrë në vërtetësinë përfundimtare të këtyre pretendimeve, problematika kryesore për raportin nuk është prova e një klientelizmi të caktuar, por fakti që në raste të tilla mungesa e transparencës mbi kontratat, procedurat dhe përfituesit realë krijon një terren të fortë mosbesimi publik. Ky shqetësim bëhet edhe më i rëndësishëm kur bëhet fjalë për pronarë mediash, pasi çdo paqartësi mbi marrëdhëniet e tyre ekonomike me shtetin prek drejtpërdrejt perceptimin mbi pavarësinë editoriale. Në këtë kontekst, rasti i Bunk'Art është domethënës edhe sepse informacioni mbi kontratën përkatëse jo vetëm që nuk ka qenë lehtësisht i aksesueshëm, por kërkesa për transparencë është kundërshtuar institucionalisht, deri në atë pikë sa çështja ka përfunduar në gjykatë pas refuzimit të Ministrisë së Kulturës për t'i vënë dokumentet në dispozicion gazetarit që i kërkoj. Kjo e zhvendos diskutimin nga meritat kulturore të projektit te një çështje më themelore. Nëse një nismë e ngritur mbi pasuri publike dhe e lidhur me një pronar mediash nuk shoqërohet me transparencë të plotë, ajo prodhon jo vetëm dyshime për favorizim, por edhe cenon besimin publik te barazia e trajtimit dhe te pavarësia e medias.

Aktivite të tjera tregtare

Në orbitën e Carlo Bollino shfaqen edhe subjekte të tjera me profil shërbimesh dhe teknologjie. Në të dhënat e regjistrimit të biznesit, shoqëria C-7 / Integrated Communication Systems rezulton me pronar përfitues Carlo Bollino (100%). Gjithashtu evidentohet edhe aktiviteti i Carlo Bollino si person fizik, me objekt konsulence/asistence dhe shërbime të natyrave të ndryshme, që plotëson panoramën e interesave ekonomike përreth medias.

Në termat e këtij raporti monitorimi, profili i Report TV/MTSC nuk trajtohet si problem “në vetvete”, por si tipologji rreziku për monitorim të thelluar. Kombinimi i ekspozimit ndaj fondeve publike me përfitime rregullatore/administrative me peshë ekonomike krijon një marrëdhënie materiale të matshme midis shtetit dhe një aktori mediatik. Kjo marrëdhënie, edhe kur ka shpjegim funksional (p.sh. investim/ndërtim infrastrukture për veprimtarinë e transmetimit), kërkon standard të lartë transparence dhe dokumentimi, pasi skema të tilla ndikojnë edhe në perceptimin publik mbi pavarësinë dhe konkurrencën në tregun audioviziv.



CARLO BOLLINO / REPORT TV

Profili i ekspozimit ekonomik dhe marrëdhënieve me shtetin

REPORT TV

1. BËRTHAMA MEDIATIKE



REPORT TV
operon përmes
MTSC sh.p.k.



Strukturë e kontrolluar
nga Carlo Bollino

2. TRANSAKSIONE THESARI (MTSC)

Periudha 2019–2026

79,763,672 lekë



5
transaksione



Përfituesi
MTSC

3. PËRDORIMI I ASETVE PUBLIKE "QIRA 1 EURO"



Ish-Ndërmarrja Metalike "Tirana"
(Reparti i orëve), Tiranë



Sipërfaqe totale
4,021 m²



Ndërtim
1,624 m²



Funkionale
2,397 m²



Afati
20 vjet

4. AKTE KRYESORE DHE ZHVILLIME



VKM nr. 642,
datë 02.10.2019

KKT miraton kontratën e qirasë "1 euro" ndërmjet Ministrisë së Financave dhe MTSC sh.p.k.



Buletini Nr. 29,
datë 22.07.2019 (APP)

Njoftohet procedura për dhënie me qira të pasurisë me vlerë dysheme **631,156 lekë/muaj.**



VKM nr. 157,
datë 19.02.2020

Shtesë kontrate për 872 m² në godinën nr. 1, kati i dytë.



VKM nr. 368,
datë 06.05.2020

Autorizohet shembja e tre objekteve (1 dy-katësh dhe 2 një-katëshe). Arsyetimi nuk shpallet.



Kalimi nga vlera e njoftuar e qirasë (631,156 lekë/muaj) në regjim "1 euro" dhe ndryshimet pasuese (shtesa, shembje) mbeten çështje e rëndësishme për monitorim dhe transparencë.

5. BUNK'ART, FONDET PUBLIKE DHE TRANSPARENCA



Janë ngritur pretendime për përfshirje në Bunk'Art 1 dhe Bunk'Art 2 dheë përdorim të asetëve publike pa transparencë të mjaftueshme mbi procedurat, kushtet kontraktore dhe përfitimet ekonomike.



Mungesa e transparencës krijon terren mosbesimi publik.



Refuzimi i Ministrisë së Kulturës për dhënie dokumentesh – çështja përfundoi në gjykatë.



Paqarësitë cenojnë besimin publik te pavarësia e medias dhe barazia e trajtimit.

6. AKTIVITETE TË TJERA TREGTARE



C-7 / Integrated Communication Systems

Pronari përfitues: Carlo Bollino (100%)

Aktivitet në fushën e komunikimit të integruar, teknologjisë dhe sistemeve.



Carlo Bollino (person fizik)

Konsulencë, asistencë dhe shërbime të natyrave të ndryshme.

7. INDIKATORËT KRYESORË TË RISKUT



Përdorim pasurie publike me tarifë simbolike (1 euro) me sipërfaqe të madhe dhe afat 20-vjeçar.



Ekspozim financiar ndaj thesarit (79,763,672 lekë) për 2019–2026.



Zinxhir aktesh shtetërore (shtesa, shembje) pa arsyetim të plotë publik.



Mungesë transparence në procese me interes publik (p.sh. Bunk'Art).



Interesa ekonomike jashtë medias që mund të krijojnë konflikt interesi.

8. REKOMANDIME PËR MONITORIM DHE TRANSPARENÇË

- 1 Publikim i plotë i kontratave të "qirasë 1 euro" dheakteve pasuese.
- 2 Rishikim i arsyetimeve për kalimin nga vlera e njoftuar e qirasë në tarifë 1 euro.
- 3 Transparencë mbi Bunk'Art (kontrata, kushtet, shumat, përfituesit).
- 4 Monitorim i vazhdueshëm i transaksioneve me fondet publike.
- 5 Ndarje e qartë e interesave dhe shmangie e konfliktit të interesit.



Profili i Report TV/MTSC trajtohet si tipologji rreziku për monitorim të thelluar.

Kombinimi i fondeve publike me përfitime rregullatore (qira 1 euro, akte shtesë) krijon ekspozim ekonomik me peshë.

Prfili i Report TV/MTSC trajtohet si tipologji rreziku për monitorim të thelluar.

Kombinimi i fondeve publike me përfitime rregullatore (qira 1 euro, akte shtesë) krijon ekspozim ekonomik me peshë.

4. Ylli Ndroqi (RTV Ora)

Pronësia mediatike dhe statusi aktual i aseteve

Rasti i Ylli Ndroqit përfaqëson një rast kufitar në tregun mediatik shqiptar, sepse nuk lidhet vetëm me ndërthurjen e zakonshme mes medias, biznesit dhe pushtetit, por me hyrjen në pronësinë mediatike të një aktori ndaj të cilit më pas u aplikuan masa sekuestrimi dhe konfiskimi mbi bazën e ligjit antimafia, duke përfshirë edhe vetë asetet mediatike. Në materialin e administruar rezulton se mes pasurive të konfiskuara përfshihen edhe RTV Ora, ndërsa statusi aktual i një pjese të pronësisë lidhet me Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara. Kjo e dallon Ylli Ndroqin nga profilet e tjera të trajtuara në raport, sepse këtu problemi nuk qëndron vetëm te konflikti i interesit apo përqendrimi i tregut, por te vetë cenimi i integritetit të pronësisë mediatike.

Portofoli i shoqërive dhe shtrirja ekonomike

Përveç pronësisë në media, materiali i mbledhur tregon se Ylli Ndroqi figuron si ortak ose i lidhur me një numër shoqëri në sektorë të ndryshëm, përfshirë media, hidrokarbure, pasuri të paluajtshme dhe aktivitete të tjera tregtare. Në listën e shoqërive të përmendura përfshihen Landon, Ren-Don, Yldon, Yldom, PS 31, Don-UCD, Yldon Media Group, Ecogades Landon Balcan, Channel One, Interkinex, RENDON OIL dhe Albanian Bay Marina. Kjo tregon se prania e tij në treg nuk ka qenë e kufizuar vetëm te televizioni, por është shtrirë në një portofol të gjerë aktivitetsesh, çka e shton rëndësinë e monitorimit të marrëdhënieve mes pasurisë, burimit të kapitalit dhe përdorimit të medias si aset ndikimi.

Një element i rëndësishëm i këtij profili është edhe ekspozimi ndaj marrëdhënieve kontraktore me shtetin. Sipas të dhënave të publikuara më herët, në vitin 2015 qeveria shqiptare firmosi një kontratë koncesioni për ndërtimin e një porti jahtesh në Durrës me kompaninë Albania Bay Marina, ku Ylli Ndroqi zotëronte 50% të aksioneve. Projekti nuk u realizua, ndërsa më pas në një process në Gjykatën e Arbitrazhit ai ka pretenduar se qeveria shqiptare ka shkelur kontratën dhe se i ka shkaktuar dëme edhe në projekte të tjera, përfshirë një resort turistik, një leje minerare për krom dhe disa licenca për hidrocentrale. Kjo pjesë e profilit tregon se rasti Ndroqi nuk është vetëm çështje e të shkuarës së pretenduar penale apo e konfiskimit të mëvonshëm, por edhe një rast ku media bashkëjeton me interesa ekonomike të lidhur me koncesione, licenca dhe projekte me peshë publike.

Të dhënat zyrtare dhe masat ndëshkuese

Pjesa më e fortë e këtij profili lidhet me masat zyrtare të ndërmarra ndaj tij. Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar vendosi konfiskimin e 26 pasurive të Ylli Ndroqit, mes të cilave edhe dy televizione. Për qëllimet e këtij raporti, këto të dhëna kanë rëndësi të veçantë sepse tregojnë se problemi i pronësisë mediatike këtu nuk është thjesht mungesë transparence, por përfshirje e pronarit në masa ndëshkuese të natyrës së rëndë.

Referencat penale në kontekstin e dokumentave të rastit Ndroqi

Materialet e publikuara përmbajnë gjithashtu referenca ndaj të dhënave që u atribuohen

autoriteteve italiane, turke, Interpol-it dhe dosjes së SPAK. Sipas këtyre materialeve, pa marrë përsipër vlerësimin e saktësisë ose plotësisë së tyre, përmenden episode të mëparshme arrestimesh, verifikimesh apo referimesh në hetime penale. Edhe njoftimi publik i SPAK i datës 3 gusht 2020 referon të dhëna me natyrë penale, të cilat paraqiten si pjesë e bazës mbi të cilën është ndërtuar veprimi institucional ndaj tij.

Për shkak se kjo pjesë mbështetet kryesisht në materiale gazetareske, njoftime publike ose dokumente që citojnë dosje dhe autoritete të tjera, ajo duhet trajtuar me kujdes të shtuar. Në këtë raport, këto të dhëna nuk përdoren si konstatime përfundimtare mbi përgjegjësi penale apo mbi vërtetësinë e pretendimeve të ngritura, por si pjesë e kontekstit dokumentar dhe publik që ka shoqëruar rastin Ndroqi. Rëndësia e tyre qëndron te fakti se ato kanë ndikuar në mënyrën se si është perceptuar profili i pronësisë mediatike, ndërhyrja e autoriteteve dhe raporti mes medias, kapitalit dhe pushtetit.

Zona gri mes pronësisë mediatike, presionit institucional dhe përdorimit instrumental të medias

Në materialet e administruara shfaqen disa episode ku vetë Ndroqi ose mediat e tij pretendojnë se janë përballur me presione nga aktorë me pushtet për të penguar ose zbutur lajme kritike, ndërsa, nga ana tjetër, ndaj tij janë ngritur çështje dhe pretendime serioze nga autoritetet. Edhe pa marrë si të mirëqena pretendimet e asnjërës palë, vetë bashkëjetesa e këtyre narrativave tregon se media, në këtë rast, ka funksionuar në një zonë veçanërisht gri, ku kufiri mes raportimit të lirë, përdorimit të medias si instrument ndikimi, presionit politik dhe ndërhyrjes institucionale mbetet i paqartë.

Ky është një element i rëndësishëm për raportin, sepse tregon se rreziku në tregun mediatik nuk vjen vetëm nga përqendrimi i kapitalit ekonomik apo nga lidhjet e pronarëve me interesa të tjera private. Ai mund të shfaqet edhe në dy drejtime të kundërta: nga njëra anë, media mund të përdoret si mburojë ndaj ekspozimit penal, administrativ ose reputacional; nga ana tjetër, veprimet penale, administrative ose gjyqësore ndaj pronarëve të medias mund të perceptohen, me të drejtë ose jo, si reagim ndaj linjës editoriale apo ndaj raportimeve kritike. Pikërisht kjo ndërthurje e bën rastin Ndroqi më kompleks dhe më të ndjeshëm për analizën e pavarësisë së medias.

Në terma të këtij raporti, rasti Ndroqi nuk mund të lexohet thjesht si histori individuale e një pronari mediash që më vonë u godit nga autoritetet gjyqësore. Ai shërben si shembull i një boshllëku më të thellë sistemik: mungesës së filtrave efektive për burimin e kapitalit, mungesës së mekanizmave të qartë për verifikimin e integritetit të pronësisë mediatike, si dhe rrezikut që media të përdoret njëkohësisht si aset ndikimi, si mburojë ndaj përgjegjësisë ose si objekt presioni nga pushteti.

Nëse profilet e tjera të trajtuara në këtë raport tregojnë rrezikun e kapjes së medias nga kapitali me ekspozim të lartë rregullator, ekonomik ose politik, rasti Ndroqi shton një dimension tjetër: rrezikun e depërtimit në media të kapitalit me origjinë të dyshuar, por edhe rrezikun paralel që ndërhyrjet shtetërore ndaj një pronari mediatik të lexohen si të ndikuara nga qëndrimi editorial i medias. Për këtë arsye, ky rast duhet të trajtohet jo si provë e njëanshme kundër një pale, por si argument për nevojën e një kuadri më të rreptë, më transparent dhe më të besueshëm për kontrollin real të pronësisë, burimit të kapitalit dhe integritetit të aktorëve që zotërojnë media me ndikim publik.



YLLI NDROQI / RTV ORA

Profil i ekspozimit ekonomik, masat ndëshkuese dhe rreziqe për pavarësinë e medias

1. PRONËSIA MEDIATIKE DHE STATUSI AKTUAL I ASETVE



RTV Ora operon nëpërmjet shoqërisë Yllon Media Group. Ylli Ndroqi ka qenë pronar i kontrollues i televizionit.



Pas masave të sekuestrimit dhe konfiskimit, RTV Ora dhe asetet e lidhura administrohen aktualisht nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara.

2. PORTOFOLI I SHOQËRIVE DHE SHTRIRJA EKONOMIKE

Ylli Ndroqi figuron si ortak ose i lidhur me një sërë shoqërisë në sektorë të ndryshëm.



MEDIA

- Yllon Media Group
- Channel One
- Interkinex



HIDROKARBURE

- RENDON OIL



PASURI TË PALUAJTSHME

- Landon
- Ren-Don
- Yllon
- Yllidom
- PS 31
- Don-UCD



AKTIVITETE TË TJERA TREGTARE

- Ecogades Landon Balkan
- Albanian Bay Marina



Prania në shumë sektorë (media, hidrokarbure, pasuri të paluajtshme, etj.) tregon një portofol të gjerë ekonomik dhe interesa të ndërlidhura.

3. MARRËDHËNIE KONTRAKTORE ME SHTETIN DHE INTERESA ME PESHË PUBLIKE



KONCESIONI I PORTIT TË JAHTEVE, DURRËS

Në vitin 2015, qeveria shqiptare firmosi kontratë koncesioni për ndërtimin e një porti jahtesh në Durrës me kompaninë Albanian Bay Marina ku Ylli Ndroqi zotëronte 50% të aksioneve.



Projekti nuk u realizua.

Më pas është pretenduar në arbitrazh se qeveria ka shkelur kontratën dhe i ka shkaktuar dëme te projektit të tjera (resort turistik, leje minerare për krom, licenca HEC).

4. TË DHËNAT ZYRTARE DHE MASAT NDËSHKUESE



Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar vendosi konfiskimin e 26 pasurive të Ylli Ndroqit, mes të cilave edhe dy televizione.



Masa përfshin pasuri të paluajtshme, shoqëri tregtare dhe asetet mediatike.

RTV Ora është një nga asetet mediatike të konfiskuara.



BAZA LIGJORE:
Ligji antimafia (nr. 138/2015)

5. REFERENCAT PENALE NË KONTEKSTIN E DOKUMENTAVE TË RASTIT



Materialet e publikuara përfshijnë referenca nga:

- Autoritetet italiane
- Autoritetet turke
- Interpol
- Dosja e SPAK



SPAK, më 3 qersbr 2020, njoftoi se ndaj Ylli Ndroqit ka indicie për vepra penale të rënda.



Kujdes metodologjik:

Të dhënat e mësipërme bazohen në materiale gazetares, përgjim të publikua dhe dokumente që citonë dosje dhe autoritete të tjera. Ato trajtohen si kontekst dokumentar, jo si konstatim përfundimtar për përgjegjësi penale.

6. ZONA GRI: MEDIA, PRESION INSTITUCIONAL DHE PËRDORIMI INSTRUMENTAL



Në materiale të administruara shfaqen episode ku media e Ndroqit pretendon se është përdorur me presione për të penguar ose zburuar lajme kritike.

Pretendime për presione ndaj linjës editoriale

Zona gri ndërthurjes

Akuza dhe masa penale/administrative ndaj pronarit



Ky rast tregon rrezikun e dyanshëm:

- 1) Media përdoret si mjet për ndaj sektorëve privatë/ekonomikë.
- 2) Veprimet e shtetit mund të perceptohen si reagim ndaj linjës editoriale.

VI. KONKLUZIONE & REKOMANDIME

A. Konkluzione

Në përfundim, çështja themelore nuk është vetëm sa media ka formalisht tregu shqiptar, por sa zëra realisht të pavarur prodhon ai. Kur pronësia përqendrohet në pak duar, kur operatorët lokalë shpesh funksionojnë si instrument i grupimeve të caktuara, kur kuadri rregullator ndalet te forma dhe nuk depërton te kontrolli real, dhe kur financimi mbetet pjesërisht i padukshëm, atëherë pluralizmi rrezikon të mbetet më shumë deklarativ sesa real. Pikërisht për këtë arsye, prioriteti nuk duhet të jetë shtimi abstrakt i rregullave, por krijimi i mekanizmave konkretë të transparencës, verifikimit dhe monitorimit efektiv.

1. **Tregu audioviziv kombëtar në Shqipëri paraqitet i përqendruar në mënyrë të lartë, sepse operatorët kryesorë kombëtarë, edhe kur formalisht shfaqen si disa subjekte të veçanta, në thelb gravitojnë rreth një numri shumë të kufizuar grupesh pronësie dhe interesash ekonomike.** Në terma praktikë, pesha kryesore e medias kombëtare përqendrohet në vetëm tre “duar”. Ky përqendrim nuk ka rëndësi vetëm si e dhënë ekonomike, por sepse ngre drejtpërdrejt çështjen e pluralizmit real, të pavarësisë editoriale dhe të aftësisë së publikut për të marrë informacion nga burime vërtet të pavarura nga njëra-tjetra.
2. **Edhe në nivelin e medias lokale dhe rajonale nuk shfaqet domosdoshmërisht një pluralizëm cilësisht i ndryshëm.** Një pjesë e konsiderueshme e këtyre mediave rezultojnë të organizuara rreth interesave të grupimeve të caktuara, familjeve ose rrjeteve të afërsisë ekonomike e shoqërore. Kjo do të thotë se fragmentarizimi formal i tregut lokal nuk duhet ngatërruar me pluralizëm real. Fakti që ka shumë operatorë nuk do të thotë vetvetiu se ka shumë zëra të pavarur, nëse këta operatorë funksionojnë si zgjatim i interesave të ngushta ekonomike, familjare ose politike.
3. **Ekspozimi i aktorëve mediatikë ndaj shtetit nuk shfaqet vetëm përmes pagesave të drejtpërdrejta nga reklamat apo transaksioneve të thesarit.** Në rastet e analizuara, përfitimi ekonomik ka marrë formë përmes statusit strategjik, përfitimeve nga pasuritë publike, aksesit mbi toka ose brigje, lejeve zhvillimore, ndryshimeve të destinacionit, masave mbështetëse apo vendimmarrjeve të tjera rregullatore me ndikim të ndjeshëm

ekonomik. Kur këto masa përfshijnë tokë shtetërore, konsolidim toke, përdorim të brigjeve ose të zonës së plazhit, efekti ekonomik mund të jetë i krahasueshëm, madje edhe më i madh, se një subvencion financiar i drejtpërdrejtë, pasi krijon mundësi zhvillimi dhe të ardhura në periudha afatgjata. Për këtë arsye, monitorimi i marrëdhënies media-shtet nuk mund të kufizohet vetëm te subvencionet ose kontratat publike klasike. Edhe kur nuk provohet automatikisht ndikim editorial, ekzistenca e këtyre përfitimeve krijon të paktën një kontekst objektiv konflikti interesi ose varësie të mundshme, që justifikon detyrimin për transparencë shumë më të lartë.

4. **Mungesa e transparencës mbi financimin direkt dhe indirekt të medias, si edhe mbi reklamimin shtetëror, e bën pothuajse të pamundur vlerësimin real të shkallës së ndikimit ekonomik.** Të dhënat e pjesshme, të fragmentuara ose vetëm statistikore të publikuara nuk mjaftojnë. Nuk mjafton të dihet sa reklama institucionale janë transmetuar ose sa minutazh është përdorur. Duhet të dihet se kush ka përfituar, sa ka përfituar, për çfarë objekti, sipas cilës procedure dhe mbi bazën e cilave kritere. Pa këtë nivel transparence, çdo diskutim mbi kapjen ekonomike të medias mbetet i cunguar.
5. **Një përfundim i veçantë që del nga rasti Ndroqi është se debati mbi pronësinë mediatike nuk mund të kufizohet vetëm te përqendrimi i tregut, konfliktet e interesit apo marrëdhëniet e medias me shtetin.** Ky rast nxjerr në pah një zonë gri më të ndërlikuar: nga njëra anë, rrezikun që media të përdoret si aset ndikimi, mburojë reputacionale ose instrument mbrojtjeje nga ekspozimi penal; nga ana tjetër, rrezikun që veprimet penale, administrative ose gjyqësore ndaj pronarëve të medias të jenë të motivuara, të instrumentalizuara ose të perceptohen si reagim ndaj linjës editoriale. Për këtë arsye, fakti që ndaj një pronari mediatik janë aplikuar masa sekuestrimi ose konfiskimi nuk mund të lexohet automatikisht si provë përfundimtare e depërtimit të kapitalit të papërshtatshëm në media. Po kështu, zotërimi i medias nuk mund të shërbejë si mbrojtje absolute ndaj verifikimit të ligjshëm të burimit të kapitalit dhe kontrollit real. Në këtë kuptim, rasti Ndroqi shërben si argument për një kuadër më të qartë, transparent dhe të paanshëm, që garanton njëkohësisht integritetin e pronësisë mediatike dhe mbrojtjen e medias nga përdorimi selektiv ose politik i instrumenteve shtetërore.

B. Rekomandime

Nga gjetjet e mësipërme del nevoja për një paketë rekomandimesh të renditura sipas rëndësisë.

1. **Zgjerimi i transparencës përtej pronësisë formale.** Transparenca duhet të përfshijë jo vetëm pronësinë e drejtpërdrejtë të medias, por edhe interesat ekonomike të lidhura me pronarët ose pronarët përfitues, si statusi strategjik, përfitimet nga pasuritë publike, lejet me efekt të madh ekonomik, përdorimi i brigjeve apo skemave mbështetëse. Deklarimi duhet të përfshijë edhe sipërfaqet, afatet, tarifat, regjimin juridik, kushtet konkrete të përdorimit, pasi këto janë të dhëna me interes të lartë publik dhe duhet të jenë të monitorueshme nga AMA.
2. **Detyrime të qarta për njoftimin e ndryshimeve në pronësi ose kontroll.** Çdo ndryshim në pronësi ose kontroll duhet të njoftohet brenda një afati të caktuar dhe të shoqërohet me sanksione reale për mosdeklarim, deklarim të pasaktë ose fshehje informacioni.
3. **Verifikimi real i vetëdeklarimeve.** AMA nuk duhet të kufizohet te publikimi i vetëdeklarimeve, por duhet të ketë detyrim për verifikim periodik, mbi bazë risku ose përmes kontrolleve të rastësishme vjetore.
4. **Regjistër publik për reklamën shtetërore dhe shpenzimet publike për media.** Duhet krijuar një regjistër publik në format open data, ku çdo institucion të publikojë shpenzimet

për media dhe komunikim: median përfituese, shumën, objektin, periudhën, procedurën dhe dokumentacionin kontraktor.

5. **Trajtimi i përqendrimeve mediatike si çështje pluralizmi.** Përqendrimet në media nuk duhet të trajtohen vetëm si transaksione ekonomike, por si çështje pluralizmi dhe pavarësie editoriale. AMA dhe autoritetet e konkurrencës duhet të përdorin një test real pluralizmi, që vlerëson kontrollin faktik, personat e lidhur, zinxhirët e pronësisë dhe ndikimin ekonomik mbi tregun e ideve. Edhe vendimmarrjet formalisht të ligjshme që favorizojnë subjekte të lidhura me pronësi mediatike duhet të jenë objekt transparence të shtuar.
6. **Databazë e unifikuar publike e pronësisë së medias.** AMA duhet të mirëmbajë një databazë publike me histori të plotë ndryshimesh, që përfshin aksionarët formalë, pronarët përfitues, pronësinë indirekte, personat e lidhur dhe elementet e kontrollit real.
7. **Rritja e transparencës së financimit të medias.** Financimi i medias duhet të raportohet në mënyrë të standardizuar, jo vetëm për burimet shtetërore, por edhe për burimet private që mund të ndikojnë pavarësinë editoriale ose perceptimin publik mbi të.
8. **Linjë e pavarur grantesh për gazetari investigative.** Duhet krijuar një linjë e posaçme, e pavarur dhe transparente grantesh për gazetari investigative, gazetarë *freelance* dhe rrjete investigimi. Skema duhet të mbështesë raportimin me interes publik, verifikimin e fakteve, kërkimin dokumentar, përdorimin e së drejtës së informimit, bashkëpunimet investigative, sigurinë digjitale dhe mbështetjen ligjore bazë. Grantet duhet të jepen përmes thirrjeve të hapura, panelit të pavarur, rregullave për konfliktin e interesit, auditit publik dhe ndalimit të çdo ndërhyrjeje editoriale.
9. **Forcimi i transmetuesit publik.** Transmetuesi publik duhet të forcohet si garant strukturor i pluralizmit, përmes pavarësisë editoriale dhe institucionale, financimit të qëndrueshëm, kapaciteteve për gazetari hulumtuese dhe mekanizmave më të fortë të llogaridhënies. Në një treg të përqendruar, ai duhet të funksionojë si kundërpeshë ndaj ndikimeve ekonomike e politike dhe si burim informacioni të pavarur e të verifikuar.
10. **Kalimi nga rregulla formale në kontroll real.** Problemi kryesor i kuadrit rregullator nuk është vetëm mungesa e rregullave, por kufizimi i tyre në nivel formal. Neni 62 i ligjit 97/2013 është pikënisje e rëndësishme, por nuk mjafton për të kapur kontrollin real, zinxhirët e pronësisë, personat e lidhur, shpërndarjen faktike të ndikimit dhe ndërthurjen me interesa të tjera ekonomike.
11. **Rishikimi i supozimit mbi formën SHA dhe objektin ekskluziv.** Forma SHA dhe objekti ekskluziv audioviziv nuk garantojnë vetvetiu transparencë reale ose pavarësi editoriale. Operatorët mund të jenë SHA të mbyllura me pronësi familjare, ndërsa interesat ekonomike që ndikojnë median mund të qëndrojnë jashtë shoqërisë së licencuar, te shoqëri të tjera të lidhura me të njëjtët pronarë.
12. **Deklarimi i pronarit përfitues dhe pronësisë indirekte.** Aksionet nominative sigurojnë vetëm transparencë formale. Kur aksioneri është person juridik, ligji duhet të kërkojë edhe deklarimin e pronarit përfitues, pronësisë indirekte dhe strukturave të ndërmjetme të kontrollit.
13. **Bërja efektive e kufirit 20%.** Ky kufi, për pjesëmarrjen në një shoqëri të dytë kombëtare, bëhet efektiv vetëm nëse matet kontrolli real, jo vetëm përqindja formale e kapitalit. AMA duhet të përdorë metodologji të detyrueshme për pronësinë indirekte dhe për trajtimin e personave të lidhur si grup i vetëm.

- 14. Monitorim aktiv edhe për licencat e tjera dhe shërbimet satelitore.** Zgjerimi i kushteve për licencat e shërbimit audio/audioviziv dhe shërbimet satelitore është i drejtë, por mbetet i kufizuar nëse nuk shoqërohet me monitorim aktiv, të dhëna të plota për pronësinë dhe koncept funksional të kontrollit real.
- 15. Transparencë financimi për licencat lokale dhe rajonale.** Regjimi i licencave lokale dhe rajonale duhet të plotësohet me transparencë financimi dhe standarde për marrëdhëniet me institucionet vendore. Mediat lokale janë më të brishta financiarisht dhe më të ekspozuara ndaj kontratave publike, reklamimit institucional dhe presioneve lokale.
- 16. Metodologji për personat e lidhur.** Rregullimi për personat e lidhur deri në shkallën e dytë duhet të bëhet funksional përmes një metodologjie të qartë agregimi. Ligji duhet të përcaktojë si mblidhen përqindjet, si identifikohen lidhjet dhe si trajtohet pronësia indirekte.
- 17. Metodologji për matjen e reklamave dhe tavanin 30%.** Ky tavan për reklamat mund të funksionojë vetëm me metodologji të qartë mbi çfarë llogaritet si reklamë, përfshirë sponsorimet, barter-in, product placement dhe format hibride të përmbajtjes së sponsorizuar. Të dhënat duhet të jenë të plota, të auditueshme dhe të verifikueshme.

* * *

Tiranë, Prill 2026

Qendra “Res Publica”
 “Ekspozimi ekonomik i medias dhe rreziqet për pavarësinë
 editoriale në Shqipëri”
 Mbështetur nga:
 National Endowment for Democracy
 Tiranë, Prill 2026
 60 faqe
 Formati: 21 x 29.7 cm
 Tirazhi 200 kopje

MEDIA MATRIX

NDËRTHURJA E INTERESAVE

Ky raport analizon ekspozimin ekonomik të medias në Shqipëri dhe ndikimin që marrëdhëniet financiare, kontratat publike, pronësia, asetet publike dhe interesat ekonomike, mund të kenë mbi pavarësinë editoriale. Përmes indikatorëve, rasteve studimore dhe një qasjeje analitike, raporti synon të ndihmojë politikëbërësit për të njohur më mirë rreziqet, nevojën për transparencë dhe forcimin e llogaridhënies publike.

